



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

RAPORT AUDITIMI PERFORMANCE

“Orientimi për karrierë i nxënësve në Sistemin Arsimor Parauniversitar”

Tiranë 2025

P Ë R M B A J T J A

1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDIMIT.....	6
1.1 Konteksti i problemit social.....	6
1.2 Rëndësia e auditimit të performancës.....	6
1.3 Auditime të mëparshme apo aktuale në këtë fushë.....	7
2. SUBJEKTI/ET NËN AUDITIM.....	7
2.1 Hyrje në subjektet nën auditim.....	7
2.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim.....	12
2.3 Rëndësia e produkteve të subjektit.....	13
2.4 Pësja në buxhet.....	13
2.5 Përkufizimet dhe terminologjia.....	15
2.6 Skema e analizës së programit auditues.....	16
2.7 Feedback-u i subjektit gjatë auditimit.....	17
3. DETAJET E AUDITIMIT.....	17
3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit.....	17
3.2 Objektivi i auditimit.....	19
3.3 Pyetjet e auditimit.....	19
3.4 Fushëveprimi i auditimit.....	20
4. SHITJELLIMI I PYETJEVE AUDITUESE.....	21
4.1 A siguron kuadri rregullator dhe strategjik orientimin e duhur për karrierë të nxënësve të sistemit të arsimit parauniversitar?	21
4.2 A realizohet me efektivitet procesi i orientimit për karrierë i nxënësve nga institucionet përgjegjëse të sistemit të arsimit parauniversitar?	29
4.3 A ka koordinim dhe raportim në mes të institucioneve përgjegjëse të sistemit të arsimit parauniversitar, në realizimin e procesit të orientimit për karrierë?	44

Lista e shkurtimeve

Shkurtimi	Emërtimi i plotë
RSH	Republika e Shqipërisë
BE	Bashkimi Evropian
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
AADF	Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim/Albanian-American Development Foundation
AFP	Arsimi dhe Formimi Profesional
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
ASCAP	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar
AKAP	Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar
DPAP	Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar
DRAP	Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar
ZVAP	Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar
KEK	Korniza Evropiane e Kualifikimeve/ European Qualifications Framework
INSTAT	Instituti i Statistikave
KSHK	Korniza Shqiptare e Kualifikimeve
LMS	Sistem për Menaxhimin e të Nxënësve/Learning Managment System
MAS	Ministria e Arsimit dhe e Sportit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
NJQV	Njësia e Vetëqeverisjes Vendore
OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim/Organization for Economic Co operation and Development
PISA	Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve/Program for International Student Assessment
PKIE	Plani Kombëtar i Integritetit Evropian
QSHA	Qendra e Shërbimeve Arsimore
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm//Sustainable Development Goals
SMIP	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar
SZHAPU	Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2014-2020
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
UNESCO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukimin, Shkencën dhe Kulturën
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
INTOSAI	The International Organization of Supreme Audit Institutions
EUROSAI	The European Organisation of Supreme Audit Institutions
AKAP	Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar
AP	Arsim Parauniversitar
AMU	Arsimi i Mesëm i Ulët
AML	Arsimi i Mesëm i Lartë

PËRMBLEDHJE

Një proces efektiv i orientimit të karrierës kontribuon që nxënësit të zhvillojnë potencialin e tyre. Ky proces u siguron nxënësve informacion dhe mbështetje të personalizuar, të paanshme dhe në kohë për të marrë vendime kuptimplota për jetën e tyre. Orientimi efektiv i karrierës ndihmon gjithashtu në zbatimin e qasjeve të të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe qasjeve aktive ndaj angazhimit në tregun e punës duke u bërë një atribut thelbësor i politikave që përpiqen të mundësojnë një ekuilibër më të mirë midis ofertës dhe kërkesës për njohuri dhe aftësi në ekonominë e sotme. Sot si rezultat i ndryshimit të kërkesës së tregut të punës, orientimi në karrierë është bërë gjithnjë e më i rëndësishëm për individët, familjet, punëdhënësit dhe shoqërinë.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, duke synuar realizimin e misionit të tij, ushtroi një auditim me temë “Orientimi për karrierë i nxënësve, në Sistemin Arsimor Parauniversitar”, për periudhën shtator 2021 – shtator 2024, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, në institucionet e varësisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar dhe Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, ku u përfshinë dhe Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar, Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar dhe institucione e arsimit parauniversitar.

Nëpërmjet këtij auditimi u analizua veprimtaria e institucioneve arsimore sipas roleve dhe përgjegjësi të gjithsecilit, për të vlerësuar nëse baza ligjore aktualisht në fuqi, politikat e parashikuara dhe praktikrat e ndjekura në vendin tonë, funksionojnë në krijimi i kushteve që nxënësit të informohen për orientimin e tyre.

Në përfundim të auditimit u evidentua se “Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026”, nuk përmban asnjë parashikim specifik lidhur me objektivat politike për orientimin e karrierës së nxënësve. Po ashtu Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rezulton se nuk ka asnjë parashikim apo rregullim të drejtpërdrejtë të procesit të orientimit për karrierë të nxënësve, në sistemin arsimor parauniversitar. Rrjedhimisht, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe institucionet e varësisë, Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale dhe zyrat vendore, nuk ka njësi të dedikuara për orientimin e karrierës, sikurse po ashtu nuk parashikohen fonde buxhetore të dedikuara për bazën logjistike dhe kapacitetet institucionale të nevojshme për këtë proces, në të gjitha nivelet e sistemit arsimor parauniversitar. Urdhrat e Ministrit të Arsimit dhe Sportit, duke filluar nga viti 2023, me objekt procesin e orientimit të karrierës rezultojnë të jenë, të paanalizuar mirë, fragmentarë, me terminologji të paunifikuar dhe të pazbatueshëm. Nga ana tjetër, mungojnë analiza nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit mbi ecurinë e procesit të orientimit pavarësisht raportimeve të institucioneve të varësisë. Paralelisht u vu re se në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe institucionet e varësisë nuk ka raporte monitorimi dedikuar orientimit të karrierës.

Deri në miratimin e Urdhrit nr. 463 datë 30 gusht 2024 përcaktimi i koordinatorëve të orientimit të karrierës është bërë mbi bazën e një vlerësimi personal të drejtuesve të shkollave, mbi kriteret të pabazuar në një akt nënligjor, ndërkohë që edhe pas miratimit të këtij urdhri, nuk ka një përcaktim të qartë të treguesve të performancës për vlerësimin e punës së mësuesit koordinator në orientimin e karrierës. Sistemi i menaxhimit të informacionit parauniversitar (SMIP), i cili do duhej të garantonte bashkëpunimin e institucioneve arsimore me prindërit, për ndërgjegjësimin e tyre lidhur me zgjedhjen e shkollimit të mëtejshëm të nxënësve, jo vetëm nuk është bërë funksional, por shfaq problematika të ndryshme.

Ministria e Arsimit dhe e Sportit nuk ka bashkërenduar veprimtaritë me të gjithë partnerët e përfshirë në procesin e orientimit të karrierës, si pushtetin vendor, sektorin privat dhe organizatat joqeveritare, për të krijuar lidhje ndërmjet shkollave dhe tregut të punës, ku nxënësit marrin informacion të drejtpërdrejtë për mundësitë e karrierës. Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar ka përgatitur dhe dërguar në drejtoritë rajonale dhe zyrat vendore,

tabelën e veprimtarive për aktivitetet e planifikuara të këshillimit të karrierës, vetëm për AML, në kuadër të Maturës Shtetërore, ndërkohë që për AMU nuk është bërë një planifikim i tillë. Për këto arsye, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe institucionet e varësisë, duhet të inkurajojnë një qasje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse që orientim për karrierën të realizohet përmes kurrikulës dhe përmes veprimtarive ekstrakurrikulare. Gjithashtu në përmirësimin e kuadrit rregullator dhe strategjik, të procesit të orientimit për karrierë të nxënësve si dhe në përmirësimin e koordinimit dhe raportimit në mes të institucioneve përgjegjëse të sistemit të arsimit parauniversitar, në realizimin e procesit të orientimit për karrierë.

1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT

1.1 Konteksti i Problemit Social

Realiteti bashkëkohor karakterizohet nga ndryshime dinamike për shkak të evoluimeve teknologjike, ekonomike, politike dhe sociale. Për pasojë, nxënësit përballen me sfida në fushën e të mësuarit, punësimit dhe kohezionit social. Arsimi është një mjet i fuqishëm për zhvillimin e aftësive për punësim dhe produktivitet, ndaj prioritet për sistemin arsimor parauniversitar në Shqipëri duhet të jetë jo vetëm krijimi i kushteve dhe mundësive që nxënësit të ndërtojnë kompetenca, të zhvillohen në mënyrë të pavarur dhe gjithëpërfshirëse, por dhe të këshillohen, informohen dhe orientohen për të përballuar me sukses sfidat e jetës dhe të tregut të punës.

Performanca e suksesshme në shkollë, punë dhe jetë mbështetet nga një gamë e gjerë aftësishë dhe vlerash, zhvillimi i të cilave kushtëzohet edhe nga sistemi arsimor, nëpërmjet procesit të orientimit për karrierë të nxënësve.

Politikat evropiane duke synuar të ndërtojnë një përparësi konkurruese të ekonomisë së BE-së, e kanë vënë orientimin në karrierë në krye të agjendës së tyre dhe kjo qasje duhet të adoptohet dhe nga vendi ynë, i cili aspirojnë të bëhet anëtar i Bashkimit Evropian.

Orientimi për karrierën (career guidance) si një nga mekanizmat e rëndësishëm për stimulimin e zhvillimit të potencialit njerëzor, përkufizohet nga Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) si: “shërbime që synojnë të mbështesin dhe ndihmojnë qytetarët e çdo moshe dhe në çdo moment të jetës së tyre, për të bërë zgjedhje lidhur me arsimin, trajnimin, zhvillimin profesional dhe punësimin, si dhe për të menaxhuar karrierën e tyre”¹.

Masat e nevojshme për të siguruar këshillimin, informimin dhe orientimin për karrierë, në vendin tonë janë bërë pjesë e përcaktimeve të disa akteve nënligjore, të viteve të fundit, duke e vënë theksin më shumë në orientimin kurrikular, si proces edukimi për karrierën dhe duke hedhur bazat e para, për orientimin ekstrakurrikular, i cili realizohet me informacionin dhe këshillimin për karrierën.

Përtej faktit se kurrikula e bazuar në kompetenca, synon t'u mundësojë nxënësve të zhvillojnë aftësitë e të nxënës gjatë gjithë jetës përmes lëndëve dhe fushave të të nxënës, shkolla duhet të ofrojë një sërë mundësish dhe përvojash, në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore, me qendrat e formimit profesional, me përfaqësuesit e sipërmarrjeve dhe me institucionet e arsimit të lartë etj.

Përpjekjet për të mbështetur orientimin për karrierën përfaqësojnë një detyrim për sistemin arsimor parauniversitar për t'iu përgjigjur kërkesave të të mësuarit të shekullit të 21-të.

1.2 Rëndësia e auditimit të performancës

Auditimet e performancës vlerësojnë nëse synimet e politikave dhe skemat qeverisëse lidhen me problemet reale të shoqërisë dhe shqetësimet e palëve të interesit, duke dhënë një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjithë projekteve dhe programeve në entet publike të audituara. Këto auditime kryhen duke u bazuar tek Standardet Ndërkombëtare ISSAI dhe Udhëzuesi i Auditimit të Performancës (ISSAI 300, 3000, 3100, 3200, 5100 dhe 5200), Manuali i Auditimit të Departamentit të Performancës, Indikatorët e Performancës sipas praktikave më të mira audituese, të cilat shërbejnë si udhërrëfyes për konceptimin, planifikimin, kryerjen, konkludimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të auditimit të performancës. Këto dokumente përmbajnë një numër udhëzimesh dhe informacionesh që marrin në konsideratë kushtet specifike dhe karakteristikat e çdo auditimi performance. Kontrolli i Lartë i Shtetit, duke synuar realizimin e misionit të tij, si institucion që ofron një ekspertizë të pavarur në ndihmë të një menaxhimi sa më të përgjegjshëm në shërbim të

¹ <http://vet.ge/wp-content/uploads/2013/10/Career-Guidance-Handbook-ENG.pdf>

qytetarëve, jep një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjitha projekteve dhe programeve të institucioneve dhe enteve publike të audituara. Nëpërmjet auditimit të performancës synohet të analizohet ekonomiciteti, efienca dhe efektiviteti i programeve të ekzekutivit.

Në linjë me prioritetet e përcaktuara në Strategjinë e Zhvillimit të KLSH-së 2023-2027, miratuar me Vendimin nr. 247 datë 29.12.2022 të Kryetarit, KLSH ndërmori auditimin “Orientimi për karrierë i nxënësve, në Sistemin Arsimit Parauniversitar”, për periudhën shtator 2021- shtator 2024”, duke e konsideruar këtë proces si një ndër çështjet e më të ndjeshme të arsimit parauniversitar, me synim garantimin e mundësive që nxënësit të bëjnë zgjedhje të përshtatshme, qoftë për vijimin e studimeve të larta, qoftë për aksesin e tyre në tregun e punës. KLSH nëpërmjet këtij auditimi synon të paraqesë situatën aktuale në lidhje me proceset e edukimit, këshillimit dhe informimit për karrierën. Në përfundim do të jepen rekomandimet përkatëse për të përmirësuar situatën aty ku është e mundur.

1.3 Auditime të mëparshme apo aktuale në këtë fushë

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në veprimtarinë e tij audituese gjatë viteve të fundit i ka kushtuar një rëndësi gjithmonë e më të madhe auditimit të veprimtarisë së institucioneve përgjegjëse për arsimin parauniversitar.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka ushtruar një sërë auditimesh pranë subjekteve nën auditim. Disa prej tyre si më poshtë:

- Auditim përputhshmërie në zbatim të Programit të Auditimit nr.895/1, datë 14.10.2022 i ndryshuar miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 14.10.2022 deri në datë 30.11.2022, në subjektin Ministria e Arsimit dhe Sporteve (këtu e më poshtë MAS), u krye auditimi “Auditim tematik përputhshmërie” për periudhën nga 01.01.2021 deri në 30.06.2022.
- Auditimi Performance me temë: “Sistemi arsimor parauniversitar për fëmijët me aftësi të kufizuara”, i miratuar në dhjetor 2023.
- Auditim përputhshmërie dhe auditim financiar të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, miratuar në prill 2022.

Gjetjet dhe konkluzionet e dokumentuara për këto auditime janë publikuar në faqen zyrtare të institucionit.

2. SUBJEKTET NËN AUDITIM

2.1 Hyrje në subjektet nën auditim

Subjektet që do të përfshihen në këtë auditim janë:

1. Ministria e Arsimit dhe e Sportit (MAS).
2. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP).
3. Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar - AKAP (ish-Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar - DPAP).
 - Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP).
 - Zyrat vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP).
 - Institucione të Arsimit Parauniversitar.

Ministria e Arsimit dhe e Sportit (MAS)

Ministria e Arsimit dhe e Sportit është ministria përgjegjëse për arsimin parauniversitar

Ndër funksionet kryesore të ministrisë, sikurse përcaktuar në ligj janë:

“zhvillimi i sistemit arsimor parauniversitar, nëpërmjet hartimit të politikave, programeve dhe projekteve të zhvillimit;

hartimi, zbatimi dhe vlerësimi i ndikimit të kuadrit rregullator të sistemit arsimor parauniversitar;

bashkëpunimi i ndërsjellë me institucionet, nëpërmjet marrëveshjeve dhe kontratave; përcaktimi i standardeve për politikën licencuese dhe kontrolluese të arsimit; financimi i sistemit arsimor parauniversitar, duke hartuar e zbatuar politikën e financimit, duke përcaktuar prioritetet dhe kërkuar burime të formave të ndryshme financimi, që do të bënin të mundur realizimin e zhvillimit të arsimit, në përputhje me rregullat e përcaktuara”².

Organigrama e MAS përfshin *Drejtorinë e Politikave të Arsimit Parauniversitar*, e cila ka shumë detyra, sikurse të listuara në nenin 11 të Urdhrit nr. 689, datë 15.11.2022, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për miratimin Rregullores së Brendshme e MAS”, ku veçojmë si më poshtë:

“menaxhon, kontribuon dhe përgjigjet për hartimin e politikave për zhvillimin e arsimit parauniversitar;

merr pjesë në procese të vendimmarrjes nëpërmjet sigurimit të të dhënave të detajuara dhe analizave për politikën e zhvillimit të arsimit parauniversitar;

jep kontribut lidhur me përgatitjen e draft-akteve ligjore, nënligjore apo dokumenteve zyrtare, të cilat mbulojnë fushën e arsimit parauniversitar”.

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) është institucion në varësi të ministrit përgjegjës për arsimin parauniversitar, i cili funksionon sipas strukturës së miratuar me Urdhër nr. 69, datë 5.4.2019, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar”.

“Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar ka përgjegjësi të:

a) organizojë punën për vlerësimin e performancës së sistemit arsimor parauniversitar, publik dhe privat;

b) organizojë zhvillimin profesional dhe kualifikimin e punonjësve arsimorë, publikë dhe privatë; c) monitorojë sigurimin e cilësisë dhe vlerësimin e institucioneve të arsimit parauniversitar, publik dhe privat, si dhe programet e tyre mësimore;

ç) sigurojë zhvillimin e kurrikulës në arsimin parauniversitar, publik dhe privat”³.

“ASCAP funksionon sipas organikës së mëposhtme:

1. Drejtori i Përgjithshëm i ASCAP-it

a) sekretar.

2. Drejtoria e Performancës drejtohet nga drejtori i kësaj drejtorie dhe përbëhet nga dy sektorë:

a) sektori i garantimit të performancës;

b) Sektori i statistikës.

3. Drejtoria e Kurrikulës dhe e Kualifikimit drejtohet nga drejtori i kësaj drejtorie dhe përbëhet nga dy sektorë:

a) sektori i zhvillimit të kurrikulës;

b) sektori i kualifikimit dhe i zhvillimit profesional.

4. Drejtoria e Vlerësimit të Cilësisë drejtohet nga drejtori i kësaj drejtorie dhe përbëhet nga dy sektorë:

a) sektori i vlerësimit të zbatimit të kurrikulës;

b) sektori i vlerësimit të organizimit dhe drejtimit në arsimin parauniversitar;

5. Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse drejtohet nga drejtori i kësaj drejtorie dhe përbëhet nga dy sektorë:

a) sektori i burimeve njerëzore dhe i shërbimeve të brendshme;

² Ligji Nr. 69 i miratuar në datën 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, dhe i ndryshuar me Ligjin nr. 56/2015 dhe Ligjin nr. 48/2018

³ VKM Nr. 98, datë 27.2.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)

b) sektori i financës”⁴.

Drejtoria e Performancës kryen detyrat, si më poshtë:

Vlerëson performancën e sistemit arsimor parauniversitar, efektshmërinë dhe eficiencën e masave, si dhe përmbushjen e objektivave;

Harton dhe i propozon Drejtorit të Përgjithshëm standarde, protokolle, rregulla për ofrimin e shërbimeve arsimore, si dhe vlerëson impaktin e tyre në këto shërbime;

Harton Raportet e Monitorimit të Performancës për periudhën, 4 (katër) mujore, 8 (tetë) mujore dhe vjetore mbështetur në tregues performance të miratuara në planin vjetor të veprimtarisë dhe pas miratimit nga Drejtorit të Përgjithshëm i boton ato në faqen zyrtare të institucionit.

Drejtoria e Kurrikulës dhe e Kualifikimit kryen detyrat, si më poshtë:

Analizon, zhvillon dhe rishikon dokumente të rëndësishme si: korniza kurrikulare, programet lëndore dhe standardet, sipas fushave/lëndëve kurrikulare;

Harton dhe boton dokumentet kurrikulare për arsimin parauniversitar si dhe materiale mbështetëse për zbatimin e kurrikulës, në nivel kombëtar;

Harton programe lëndore për të gjitha ciklet (arsimi parashkollor dhe klasat 1-12);

Harton dhe boton udhëzues kurrikularë, si dhe materiale mbështetëse për zbatimin e kurrikulës në nivel kombëtar;

Harton, analizon dhe rishikon standardet e zhvillimit profesional të mësuesve dhe të drejtuesve të institucioneve arsimore parauniversitare;

Vlerëson nevojat për zhvillim profesional, programet kombëtare dhe materialet mbështetëse për zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë;

Harton programe kombëtare orientuese për kualifikimin dhe zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë në arsimin parauniversitar;

Mbështet funksionimin e rrjeteve profesionale dhe zhvillimin profesional të vazhdueshëm të drejtuesve të këtyre rrjeteve nëpërmjet instrumenteve përkatëse;

Menaxhon procesin e akreditimit të programeve/moduleve të trajnimit për zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë;

Realizon punë kërkimore-studimore, analiza periodike dhe u ofron ekspertizë strukturave politike e vendimmarrëse për politikën arsimore dhe reformat në fushën e arsimit parauniversitar;

Ofron këshillim për institucionet arsimore parauniversitare të të gjitha niveleve, në fushat e përmbajtjes kurrikulare, përdorimit të teknologjive moderne në mësimdhënie, si dhe për drejtimin e menaxhimit e shkollës dhe të arsimit në tërësi;

Bashkërendon veprimtarinë e saj me drejtorinë dhe sektorët e tjerë të ASCAP-it, me ministrinë përgjegjëse për arsimin, si dhe me institucione të tjera të të gjitha niveleve brenda dhe jashtë vendit, për realizimin cilësor të detyrave të saj;

Totali i strukturës së këtij institucioni është 58 punonjës.

⁴ Urdhër nr. 32, datë 28.1.2020, i Ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për miratimin e rregullores “”Për përcaktimin e metodave të brendshme të punës dhe sjelljes së personelit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësië në Arsimin Parauniversitar””.

Figura 1. Pjesë e organigramës⁵ së Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)



Burimi ASCAP

Përpunoi: Grupi i auditimit

Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar – AKAP (ish - Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar - DPAP)

Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar - AKAP (Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar - DPAP), Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar - DRAP) dhe Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar – ZVAP, janë krijuar me VKM nr. 99, datë 27.02.2019 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”.

AKAP është person juridik, publik, buxhetor, që zhvillon aktivitetin e saj në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe është në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

AKAP ka për mision ofrimin dhe sigurimin e shërbimit arsimor cilësor në të gjitha institucionet arsimore të sistemit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me politikat, strategjitë kombëtare dhe kurrikulën e arsimit parauniversitar, me qëllim zhvillimin dhe edukimin e plotë e të gjithanshëm të nxënësit, në mënyrë që të përballojë sfidat e së ardhmes.

“DPAP-ja e shtrin veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ajo organizohet në:

- a) nivel qendror, nëpërmjet *drejtorisë qendrore*;
- b) nivel rajonal, nëpërmjet *drejtorive rajonale të arsimit parauniversitar*;
- c) njësitë e ofrimit direkt të shërbimeve, të cilat përfshijnë *zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore të sistemit parauniversitar publik*”⁶.

“DPAP ka këto përgjegjësi:

1. Të ofrojë shërbim cilësor në sistemin arsimor parauniversitar nëpërmjet monitorimit, vlerësimit dhe inspektimit.
2. Të organizojë punën për menaxhimin, ndjekjen dhe kontrollin e institucioneve të sistemit

⁵ Urdhër nr. 69, datë 5.4.2019, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar”

⁶ VKM nr. 99, datë 27.2.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar

arsimor parauniversitar për pajtueshmërinë e veprimtarisë së tyre me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

3. Të koordinojë administrimin e burimeve njerëzore në sistemin arsimor parauniversitar publik, sipas legjislacionit në fuqi...”⁷.

Ministria e Arsimit dhe e Sportit përfaqësohet në nivel rajonal nga *Drejtoria Rajonale të Arsimit Parauniversitar – DRAP-et*, të cilat janë në varësi administrative të AKAP.

ZVAP-et (ZVA) funksionojnë si njësi e ofrimit direkt të shërbimeve dhe janë në varësi administrative të DRAP-ve.

Tabela 1. Organigrama dhe struktura⁸ sipas DPAP-AKAP/DRAP-e

INSTITUCIONI	Organika	DREJTOR	Sekretar	Kordinator I Rrjetit Antikorrupsion	Sektori I BNJ Shërbimeve dhe Statistikës		Sektori i Monitorimit të kurrikulës dhe zhvillimit profesional.		Sektori i Inspektimit dhe Vlerësimit të Cilësisë	
					P/Sektori	Specialist	P/Sektori	Specialist	P/Sektori	Specialist
DPAP	21	1	1	1	1	4	1	5	1	6
DRAP Durrës	15	1	1	1	1	3	1	3	1	3
DRAP Fier	15	1	1	1	1	3	1	3	1	3
DRAP Korçë	15	1	1	1	1	3	1	3	1	3
DRAP Lezhe	15	1	1	1	1	3	1	3	1	3

Burimi AKAP , Përpunoi: Grupi i auditimit

Për institucionet arsimore të sistemit parauniversitar publik, lidhur me orientimin për karrierë të nxënësve, “Rregullorja e Funksionimit të Institucioneve Arsimore Parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, parashikon se: “Drejtoria e shkollës së arsimit të mesëm të lartë organizon me nxënësit e vitit të fundit dhe me personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të tyre: a) takime me pedagogë të degëve të institucioneve të arsimit të lartë; b) vizita në mjedise të mundshme për punësim”⁹ sikurse dhe ngarkon me përgjegjësi mësuesit kujdestarë: “Mësuesi kujdestar kujdeset posaçërisht për: D) plotësimin e pëlqimeve të nxënësve për kurrikulën me zgjedhje; E) këshillimin e nxënësve në zgjedhjet kurrikulare dhe zgjedhjet e karrierës”¹⁰.


⁷ VKM nr. 99, datë 27.2.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar

⁸ Urdhër nr. 68, datë 5.4.2019, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar”

⁹ Urdhër Nr. 31, datë 28.1.2020, e Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, neni 79, paragrafi 1.

¹⁰ Urdhër Nr. 31, datë 28.1.2020, e Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, neni 66, paragrafi 3.

Figura 2. Skema e shtrirjes së veprimtarisë së AKAP (ish – DPAP) në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë



Burimi: Nga informacioni i vënë në dispozicion nga AKAP.

Përpunoi: Grupi i auditimit

2.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim

2.2.1 Kriteret politike:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- Ligji nr. 69 i miratuar në datën 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, dhe i ndryshuar me ligjin nr. 56/2015 dhe ligjin nr. 48/2018.
- VKM 621, datë 22.10.2021 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021-2026.
- Të tjera.

2.2.2 Kriteret teknike dhe të monitorimit

- VKM nr. 98, datë 27.2.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP).
- VKM nr. 129, datë 6.3.2024 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 99, datë 27.2.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”.
- Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Sportit, nr. 600, miratuar më 19.10.2023 “Udhëzuesi i Orientimit për Karrierën e Nxënësve në AMU (klasat 6-9)”.
- “Udhëzuesi i Orientimit për Karrierën” në klasën e 9”, miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Sportit me nr. prot. 246/1, më datë 13.01.2023.
- VKM nr. 99, datë 27.2.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar.
- Rregullore "Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, miratuar më 30.04.2019, me nr. Prot. 4699/1, nga Ministri i Arsimit dhe i Sportit.
- Urdhër nr. 68, datë 5.4.2019, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar”.
- Urdhër nr. 69, datë 5.4.2019, e Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar”.
- Urdhër nr. 144, datë 16.12.2021, e Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”.

- Urdhër nr. 215, datë 13.12.2023, e Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”.
- Urdhër nr. 31, datë 28.1.2020, i Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”.
- Urdhër nr. 234, datë 19.04.2019, e Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së zyrave vendore të arsimit parauniversitar”.
- Urdhër nr. 689, datë 15.11.2022 e Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për miratimin Rregullores së Brendshme e MAS”.
- Urdhër nr. 32, datë 28.1.2020, i Ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për miratimin e rregullores ‘Për përcaktimin e metodave të brendshme të punës dhe sjelljes së personelit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar”.
- Korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar të Republikës së Shqipërisë, miratuar në 2014 nga MAS¹¹.
- Council Resolution on a strategic framework for European cooperation in education and training towards the European Education Area and beyond (2021-2030) (2021/C 66/01)¹².
- Të tjera.

2.3 Rëndësia e produkteve të subjektit

“Udhëzuesi i Orientimit për Karrierën” në klasën e 9”, miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Sportit me nr. prot. 246/1, më datë 13.01.2023 dhe Urdhri i Ministrit të Arsimit dhe Sportit, nr. 600, miratuar më 19.10.2023 me objekt, “Udhëzuesi i Orientimit për Karrierën e Nxënësve në AMU (klasat 6-9)”, janë dy dokumente të rëndësishëm sa i përket problematikës së orientimit për karrierë në arsimin parauniversitar. Udhëzuesi i orientimit për karrierën u hartua nga grupi i punës me përfaqësues të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS), Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP) në bashkëpunim me drejtues të shkollave në arsimin bazë. Udhëzuesi orienton koordinatorët e orientimit për karrierën, mësuesit, drejtuesit e shkollave, punonjësit e shërbimit psiko-social, si dhe aktorë të tjerë të angazhuar në këtë proces. Ky Udhëzues vë në dukje se, “Orientimi për karrierën ka si qëllim mbështetjen e nxënësve për të kuptuar veten dhe mjedisin në të cilin jetojnë, duke u siguruar mundësi dhe përvoja në mënyrë që ata të pajisen me aftësi dhe kompetenca për të vendosur për rrugët e arsimimit të tyre të mëtejshëm dhe përgatitjen për botën e punës”¹³.

Ministria e Arsimit dhe e Sportit, në cilësinë e organit politikë bërës, duhet të hartojë një kuadër rregullator dhe politik, për këshillimin e karrierës në arsimin parauniversitar, me synim planifikimin dhe zbatimin e tyre.

Sipas Urdhrit nr. 31, datë 28.1.2020, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, drejtoritë e institucioneve të arsimit parauniversitar, ngarkohen me përgjegjësi të posaçme për menaxhimin e orientimit për karrierë, vetëm për nxënësit e klasave të fundit të AMU dhe AML.

2.4 Pesha në buxhet

Ministria e Arsimit dhe Sportit, është autoriteti më i lartë ekzekutiv i menaxhimit të arsimit parauniversitar, e cila ka për mision zbatimin e politikave kombëtare arsimore, të përcaktuara

¹¹ <https://ascap.edu.al/wp-content/uploads/2017/03/Korniza-Kurrikulare.pdf>

¹² [Council resolution on a strategic framework for european-c .pdf](#)

¹³ Urdhri i Ministrit të Arsimit dhe Sportit, Nr. 600, miratuar më 19.10.2023 me objekt, “Udhëzuesi i Orientimit për Karrierën e Nxënësve në AMU (klasat 6-9)”

nga Këshilli i Ministrave dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit arsimor për të gjithë qytetarët shqiptarë. MAS harton dhe ndjek zbatimin e strategjive kombëtare arsimore, bazës ligjore për arsimin, nxjerrjen e akteve nënligjore, planifikon buxhetin, si dhe bashkëpunon me njësitë themelore të qeverisjes lokale, përcakton standardet e kurrikulës, administrative dhe infrastrukturore si dhe harton politikat e zhvillimit profesional.

Për periudhën në fokus auditimi, (shtator 2021-shtator 2024), e cila përkon me vitet buxhetore të mbyllura 2021, 2022, 2023 dhe me vitin e papërfunduar 2024, Ministria e Arsimit dhe Sportit nuk ka pasur asnjë program, produkt, apo nënprodukt buxhetor të përcaktuar për orientimin e karrierës për nxënësit. Ministria e Arsimit dhe Sportit në përgjigjen e saj, në lidhje me buxhetet e planifikuara dhe realizuara për orientimin e karrierës të nxënësve është shprehur: “*Buxheti është i miratuar me programe buxhetore dhe nuk ka buxhet të veçantë për orientimin për karrierë*”.¹⁴

MAS nuk ka një analizë të detajuar se sa prej shpenzimeve për paga rezultojnë, për mësuesit kujdestarë, mësuesit e lëndës, psikologët, mësuesit ndihmës, drejtuesit e institucioneve arsimore, si dhe punonjësit e tjerë, në funksion të identifikimit të nevojave të nxënësve për orientimin për karrierë dhe për realizimin e veprimtarive mbështetëse, për këtë objekt.

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë të Arsimit Parauniversitar (ASCAP) ka për mision të garantojë performancën e sistemit të arsimit parauniversitar dhe cilësinë e arsimit parauniversitar publik dhe privat, në përputhje me qasjen e kurrikulës së bazuar në zhvillimin e kompetencave.

Po ashtu edhe ASCAP nuk është mbështetur me fonde buxhetore të dedikuara për orientimin për karrierë të nxënësve, gjatë periudhës në fokus auditimi, sikurse pohohet prej vetë Agjencisë: “Përsa i përket buxhetit të akorduar ne nuk kemi buxhet të dedikuar dhe kode specifike për orientimin për karrierë të të rinjve, në Sistemin Arsimor Parauniversitar, për periudhën objekt auditimi shtator 2021 – 4 korrik 2024”¹⁵.

Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (AKAP), që ka për mision ofrimin dhe sigurimin e shërbimit arsimor cilësor në të gjitha institucionet arsimore të sistemit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, nënvizon se, nuk ka produkte buxhetore të detajuara për karrierën si dhe asnjë studim të mirëfilltë për të përcaktuar se sa mund të jenë shpenzimet për paga të punonjësve, të cilët përveç detyrave parësore të rolit, merren edhe me orientimin e karrierës. Këta punonjës të sistemit të arsimit parauniversitar janë: koordinatori në shkollë për karrierën, koordinatori për karrierën në ZVAP, në DRAP, në DPAP dhe AKAP. Me poshtë paraqiten shpenzimet faktike buxhetore të realizuara nga AKAP, ASCAP dhe MAS për vitet buxhetore 2021, 2022, 2023.

Tabela 2. Buxhetet faktike të AKAP, ASCAP dhe MAS, për 2021-2023 në lekë

Nr.	Viti	AKAP (ish-DPAP) Buxheti faktik	ASCAP Buxheti faktik	MSHMS Buxheti faktik	Pesha që zë - buxheti i AKAP / MAS	Pesha që zë buxheti i ASKAP / MAS
1	2021	23,029,920	153,503,815	41,906,000,000	0.05%	0.37%
2	2022	28,074,765	142,661,324	44,110,200,000	0.06%	0.32%
3	2023	37,986,392	185,550,865	48,623,173,908	0.08%	0.38%

Burimi: AKAP, ASCAP dhe MAS

Përpunoi: Grupi i auditimit

¹⁴ Kthim përgjigje të pyetësorit, më datë 26.06.2026

¹⁵ Kthim përgjigje të pyetësorit, më datë 26.06.2026

Siç vërehet edhe në tabelën e mësipërme shpenzimet buxhetore të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar dhe Agjencisë të Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, në raport me shpenzimet buxhetore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit janë të papërfillshme.

2.5 Përkufizimet dhe terminologjia

Në kuptim të këtij auditimi, me termat e mëposhtëm nënkuptojmë:

"Arsimi parauniversitar" përfshin nivelet arsimore me kodet 0, 1, 2 dhe 3, sipas "Klasifikimit Ndërkombëtar Standard të Arsimit", të miratuar nga Konferenca e Përgjithshme e UNESCO-s, në sesionin e 29-të të saj, në nëntor 1997, përkatësisht: a) "Niveli me kodin 0", arsimi parashkollor; b) "Niveli me kodin 1", arsimi fillor; c) "Niveli me kodin 2", arsimi i mesëm i ulët; ç) "Niveli me kodin 3", arsimi i mesëm i lartë¹⁶.

"Fushë e të nxënësve" është një lëndë ose bashkësi lëndësh që shqyrtojnë realitetin nga këndvështrime të caktuar.

"Gjimnaz" është shkolla e mesme e përgjithshme.

"Institucion arsimor" është kopshti ose shkolla.

"Institucion arsimor plotësues" është institucioni që pasuron përvojat mësimore dhe jetësore të nxënësve.

"Këshilli i prindërve" është organ i përbërë nga përfaqësues të prindërve të nxënësve të institucionit arsimor.

"Kurrikula" është sistem i përbërë nga disa elemente, si: korniza, kurrikulare, kurrikula bërthamë, programet mësimore, vlerësimi, që, të lidhura mes tyre, lejojnë të orientohej dhe të funksionojë sistemi arsimor, nëpërmjet planeve arsimore dhe administrative. Kurrikula siguron arsimim cilësor dhe të barabartë për çdo pjesëtar të shoqërisë, pavarësisht nga përkatësia etnike, seksi, pozita shoqërore.

"Kornizë kurrikulare" është dokumenti themelor i kurrikulës, ku përshkruhen synimet e përgjithshme të saj, kompetencat themelore, rezultatet e pritshme për nxënësit, për sa i përket dijeve, aftësive dhe qëndrimeve në fund të arsimit bazë dhe atij të mesëm të lartë, synimet e fushave të të nxënësve dhe parimet e përgjithshme të procesit të mësimdhënies e nxënies e të vlerësimit të nxënësve.

"Kompetenca themelore" është kompetenca, për të cilat kanë nevojë të gjithë individët për plotësim dhe zhvillim vetjak, për qytetari aktive, për përfshirje shoqërore dhe për punësim.

"Kurrikula bërthamë" është kurrikule e përbashkët për të gjithë nxënësit e një niveli në sistemin arsimor.

"Ministria" është ministria që mbulon çështjet e arsimit parauniversitar.

"Mësues" është personi që ka fituar të drejtën për të ushtruar profesionin e mësuesisë në arsimin parauniversitar.

"Nxënës" është personi që arsimohet në arsimin parauniversitar.

"Program mësimor" është dokumenti që përmban synimet, objektivat dhe rezultatet e të nxënësve, metodologjitë e të nxënësve dhe të vlerësimit për një lëndë ose fushë të caktuar.

"Shkollë" është institucioni që ofron shërbim arsimor për nivelet me kodet 1, 2, 3.

"Shkollë private" është shkolla jopublike, e cila nuk themelohet, financohet dhe administrohet nga qeveria qendrore ose vendore.

"Veprimtari plotësues" janë veprimtaritë që planifikohen nga institucioni arsimor dhe kanë për qëllim pasurimin e përvojave mësimore e jetësore të nxënësve.

"Informacioni për karrierën" përfshin informacionin rreth institucioneve arsimore të arsimit të mesëm të lartë dhe shtigjeve të karrierës që lidhen me ndjekjen e tyre, rreth lëndëve/ fushave

¹⁶Ligji Nr. 69 i miratuar në datën 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", dhe i ndryshuar me Ligjin nr. 56/2015 dhe Ligjin nr. 48/2018.

të studimit dhe mundësive që ato ofrojnë për punësim dhe avancim në karrierë, rreth kurseve të formimit/trajnitimit, profesioneve dhe drejtimeve të mundshme të karrierës, etj.¹⁷

“Këshillimi për karrierën” mund të kryhet në baza individuale ose me fokus grupe, ku vëmendja fokusohet tek problemet apo zgjedhjet specifike në lidhje me karrierën, me të cilat ballafaqohen nxënësit.


“Edukimi për karrierën” realizohet përmes kurrikulës (njohurive që marrin nxënësit përmes fushave të të nxënës dhe lëndëve që i përbëjnë ato, në lidhje me botën ekonomike, sociale, profesionet etj., aftësive dhe qëndrimeve që zhvillojnë përmes veprimtarive/projekteve kurrikulare etj.), dhe përmes veprimtarive ekstrakurrikulare.

2.6 Skema e analizës së programit auditues

Ky auditim do të fokusohet në analizimin e politikave dhe veprimtarive për këshillimin e karrierës të nxënësve në arsimin parauniversitar, duke patur parasysh rolet dhe detyrat e subjekteve, sipas fushave të tyre të përgjegjësisë, duke u fokusuar veçanërisht në:

- Në nevojën e një vizioni të Ministrisë së Arsimit dhe të Sportit për orientimin për karrierë në AP.
- Në nevojën e hartimit të politikave që garantojnë një proces efektiv orientimi për karrierë.
- Nevojën për alokime buxhetore dhe vënien në dispozicion të kapaciteteve njerëzore, në mbështetje të procesit të orientimit.
- Rolin dhe përgjegjësinë që kanë strukturat.
- Sistemin e raportimit, kontrollit dhe monitorimit të procesit të orientimit për karrierë.

Figura Nr. 3 Skema e analizës së programit auditues



Punoi: Grupi i auditimit

¹⁷ Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Sportit, Nr. 600, miratuar më 19.10.2023 “Udhëzuesi i Orientimit për Karrierën e Nxënësve në AMU (klasat 6-9)”.

2.7 Feedback-u i subjektit në fazën studimore

Gjatë fazës studimore, subjektet nën auditim, i janë përgjigjur përgjithësisht në kohë takimeve prezantuese dhe konsultuese, por nuk i janë përgjigjur në të njëjtën mënyrë plotësimit të informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar, që lidhet me vjeljen e të dhënave paraprake.

Veçanërisht MAS, pavarësisht qëndrimit mirëkuptues nga ana e grupit të auditimit, ka shfaqur vonesa në dhënien e informacionit dhe veç kësaj, informacioni i dërguar ka rezultuar i pa plotë, duke bërë të detyrueshëm përsëritjen e kërkesave të grupit të auditimit për plotësimin e tij.

Vlen të theksohet gatishmëria e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë të Arsimit Parauniversitar (ASCAP), gjatë gjithë fazës studimore në lidhje me kërkesat e grupit të auditimit.

3. DETAJET E AUDITIMIT

3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit


Risqet e politikave dhe aktiviteteve të subjekteve të përfshira në këtë auditim, kanë të bëjnë me vështirësitë dhe pengesat që ato hasin në realizimin e detyrave dhe funksioneve të përcaktuara në kuadrin ligjor e rregullator në fuqi. Për të kryer analizën e riskut, jemi mbështetur në analizën SWOT duke marrë në konsideratë fuqitë, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet që paraqiten në veprimtarinë e subjekteve nën auditim, që lidhen me fushën e sigurisë kibernetike. Analiza SWOT është një kornizë që përdoret për të identifikuar dhe analizuar fuqitë, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet që paraqiten lidhur me çështjen që trajtohet. Analiza SWOT është e dizajnuar për të ofruar një qasje realiste, të bazuar në fakte dhe të dhëna e cila përdor burime të brendshme dhe të jashtme dhe përdoret si një teknikë për të vlerësuar performancën, risqet dhe mundësitë potenciale për zhvillim dhe arritjen e objektivave. Për kryerjen e analizës grupi i auditimit ka përcaktuar objektivin që synohet të arrihet përmes këtij auditimi, ka mbledhur të dhëna dhe evidenca dhe ka bashkërenduar mendimet dhe konceptet e secilit prej anëtarëve të grupit.

U përzgjedh përdorimi i analizës SWOT nisur nga fakti që kjo analizë ofron mundësinë e mirë menaxhimit të një problemi kompleks siç është efektiviteti i pajisjeve mjekësore.

Duke iu referuar evidentimit të fuqive, dobësive, shanseve dhe kërcënimeve të paraqitur në analizën SWOT, grupi i auditimit ka bërë një ndarje dhe grupim të risqeve të veprimtarisë së institucioneve përkatëse, për të adresuar dhe ndarë faktorët e riskut sipas përkatësisë së tyre, brenda kontrollit dhe jashtë kontrollit menaxherial.

Gjithashtu është bërë edhe kategorizimi i tyre në strategjik, financiar, juridik dhe operacional.

Figura Nr. 4 Analiza SWOT



Burimi: Grupi i auditimit

Tabela Nr. 3: Analiza e Riskut

Nr.	Risku i Subjektit	Kategorizimi i riskut	Niveli i Riskut
	Përcaktimi jo i qartë i rolit, përgjegjësisë dhe detyrave funksionale të subjekteve.	Risk Strategjik	I lartë
	Mospërditësimi i kuadrit rregullator në përputhje me direktivat e BE.		I lartë
	Mungesa të dhënash dhe analizash të thelluara		I lartë
	Mosparashikim fondesh buxhetore	Risk Financiar	I lartë
	Mungesa e parashikimit të orientimit, në Strategji dhe në Ligj, si dhe për një pjesë të ciklit të AML, në akte rregullatore.	Risk Rregullator dhe Strategjik	I lartë
	Mungesë strukturash të dedikuara.		I lartë
	Monitorim dhe koordinim i pamjaftueshëm.	Risk Operacional	I mesëm
	Mungesa të dhënash dhe analizash të thelluara.		I lartë
	Formalizmi i procesit të orientimit.		I mesëm
	Mungesë bashkëpunimi me aktorë të tjerë në proces.		I lartë
			I lartë

Burimi: Grupi i Auditimit


3.2 Objektivi i auditimit

Auditimi me temë “Orientimi për karrierë i nxënësve, në Sistemin Arsimor Parauniversitar”, për periudhën shtator 2021- shtator 2024”, ka si objektiv kryesor vlerësimin e vizionit politikë bërës mbi këtë proces dhe mekanizmat e ngritura për realizimin e tij.

Në këtë mënyrë do të synohet të sigurohet një vlerësim i paanshëm dhe objektiv nëse rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve janë të qarta, nëse strukturat aktuale, si dhe veprimtaria zhvilluar prej tyre garantojnë një ofrim efektiv të orientimit për karrierë të nxënësve në sistemin e arsimit parauniversitar.

3.3 Pyetjet e auditimit

Figura Nr. 5: Piramida e pyetjeve audituese



3.4 Fushëveprimi i auditimit

Ky auditim ka pasur si fushëveprimi analizimin dhe dhënien e një opinioni mbi ecurinë e procesit të orientimit për karrierë të nxënësve të inkuadruar në sistemin e arsimit parauniversitar. Auditimi për shkak të kompleksitetit të tij do të ketë një qasje në nivel makro duke parë nga perspektiva e detyrimeve që subjektet kanë në lidhje me këtë proces.

Periodha e auditimit ka qenë shtator 2021 – shtator 2024. Gjatë këtij auditimi do të fokusohemi në mënyrë të veçantë në veprimtarinë e shumë institucioneve të arsimit parauniversitar, si dhe të Ministrisë së Arsimit dhe të Sportit, Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar. Numri i lartë i institucioneve që që i janë nënshtruar auditimit, ka krijuar kushte për të pasur një panoramë më të plotë lidhur me fokusin e auditimit.

Mbetet një problem konstant fakti, që kuadri rregullator që ngarkon me detyrime e përgjegjësi subjektet, sa i përket orientimit për karrierë, është miratuar vetëm në vitin 2023, përjashtuar një parashikim të padetajuar në Urdhrin Nr. 31, datë 28.1.2020, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”. Ndaj bazuar në sa më sipër, auditimi është fokusuar në përgjegjësitë dhe veprimtarinë e subjekteve, lidhur me orientimin për karrierë të nxënësve në arsimin parauniversitar, pa pasur mundësi të vlerësojmë shkallën e zbatimit të politikave qeveritare, përderisa për këtë çështje, nuk ka asnjë parashikim në Strategjinë e Zhvillimit të Arsimit 2021 – 2026.

4. SHTJELLIMI I PYETJEVE AUDITUESE

Pyetja kryesore: A ofron sistemi i arsimit parauniversitar orientim për karrierë të nxënësve?

Mesazhi i auditimit

Mungesa e një vizioni të qartë politik, mungesa e strukturave dhe fondeve buxhetore, mungesa e marrëveshjeve me grupet e interesit, si dhe mos analizimi i ecurisë së procesit të orientimit të karrierës, kanë sjellë planifikime formale të veprimtarive për këtë qëllim, duke penguar krijimin e një mekanizmi të qëndrueshëm midis institucioneve të arsimit parauniversitar, tregut të punës, si dhe gjithë aktorëve të tjerë të përfshirë në proces. Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe institucionet e varësisë, duhet të nxisin një qasje bashkëkohore dhe ndërgjegjësuere, ndaj procesit të orientimit të karrierës së nxënësve në sistemin e arsimit parauniversitar, nëpërmjet përmirësimit të kuadrit ligjor dhe rregullator, si dhe praktikave më të mira.

4.1 A siguron kuadri rregullator dhe strategjik orientimin e duhur për karrierë të nxënësve të sistemit të arsimit parauniversitar?

Strategjia dhe legjislacioni për sistemin arsimor parauniversitar nuk përmbajnë parashikime të drejtpërdrejta mbi procesin e orientimit për karrierë të nxënësve, në sistemin e arsimit parauniversitar. Urdhrat e Ministrit të Arsimit dhe Sportit, nr. 31, datë 28.1.2020 dhe nr. 600, miratuar më 19.10.2023, nuk kanë fokusuar nevojën e rregullimit të procesit të orientimit të karrierës për arsimin e mesëm të lartë dhe terminologjia e përdorur në to, është e paunifikuar. Urdhri nr. 463, i miratuar më datë 30.08.2024, është i pjesërisht i pazbatueshëm.

➤ ***Orientimi për karrierë në dokumentet e organizmave të huaj.***

Orientimi për karrierën i ndihmon individët të zbulojnë potencialet e tyre, ekonomitë të rrisin efikasitetin e tyre dhe shoqëritë të zhvillohen më shumë. Orientimet janë thelbësore për tranzicionin e qetë të individëve teksa ata bëjnë zgjedhje për arsimimin, trajnimin dhe për lëvizshmërinë brenda tregut të punës.

Në dhjetor 2019, gjashtë organizata ndërkombëtare (KOMISIONI EUROPIAN, ETF, UNESCO, OECD, CEDEFOP, ILO) u mblodhën për të botuar një broshurë¹⁸ të parë mbi rëndësinë e investimit në karrierë. Përpjekja e përbashkët pasqyroi faktin se nevoja për orientim në drejtim të karrierës për t'u përmirësuar dhe për t'u rikualifikuar, ishte më e madhe tek ata persona që kishin qëndruar më gjatë në arsim dhe trajnim.

Orientimi për karrierën përshkruan shërbimet që ndihmojnë njerëzit e çfarëdo lloj moshe të menaxhojnë karrierën e tyre, të bëjnë zgjedhjet arsimore dhe trajnimet profesionale që janë të rëndësishme për ta. Ai i ndihmon njerëzit të reflektojnë mbi ambiciet, interesat, kualifikimet, aftësitë dhe talentet e tyre, si dhe të lidhin njohuritë dhe aftësitë që ata kanë me atë që mund të bëhen në jetë dhe në punë. Individët, familjet dhe komunitetet ndryshojnë në masën në të cilën ata janë në gjendje të vizualizojnë dhe planifikojnë të ardhmen e tyre. Në këto raste është shumë i rëndësishëm roli i orientimit në karrierë për të adresuar dallime dhe pabarazi të tilla.

“Qëllimi i përgjithshëm i orientimit për karrierën është të zhvillojë kapacitetin e individëve për të menaxhuar karrierën e tyre (të njohura si 'aftësitë e menaxhimit të karrierës').

¹⁸ https://www.etf.europa.eu/sites/default/files/2021-09/investing_in_career_guidance.pdf

Ai përfshin një sërë aktivitete të ndërlidhura mësimore që i ndihmon individët të kenë akses në shërbime, burime dhe përvoja në lidhje me arsimimin, me punësimin dhe me trajnimin e mëtejshëm të tyre. Këto ofrojnë:

- edukimin për karrierën
- informacion për karrierën
- orientime/këshillime individuale dhe në grup
- vlerësimin e aftësive dhe testimin psikometrik
- angazhimin me punëdhënësit
- zhvillimin e aftësive të nevojshme për kërkimin e punës dhe vetëpunësimin¹⁹.

➤ ***Ligji Nr. 69 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i miratuar në datën 21.06.2012, i ndryshuar²⁰, nuk trajton në mënyrë të drejtpërdrejtë çështjen e orientimit të karrierës së nxënësve.***

Lidhur me këtë Ligj, Ministria e Arsimit dhe Sportit nga ana e saj shprehet: “Në përmbushje të synimeve të ligjit, veprimtaritë dhe shërbimet e orientimit për karrierën në arsimin parauniversitar mbështesin nxënësit të zhvillojnë kompetencat, të përgatiten për kalimet nga një nivel i arsimit në tjetrin dhe për tregun e punës”²¹.

Këtë vlerësim të saj, MAS e mbështet në faktin se Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dy herë, me Ligjin nr. 56/2015 dhe Ligjin nr. 48/2018, në nenin 3 të tij shprehet, se “sistemi arsimor parauniversitar ka për qëllim krijimin e kushteve dhe mundësive që nxënësit të aftësohen për jetë dhe për punë në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore”.

Po ashtu, MAS referon se neni 22 i këtij ligji përcakton, se “arsimi bazë synon zhvillimin shoqëror, intelektual e fizik të çdo nxënësi, zotërimin e rregullave të sjelljes dhe kultivimin e vlerave, përkujdesjen për shëndetin, si dhe përgatitjen e mjaftueshme për vazhdimin e arsimit të mesëm të lartë ose për tregun e punës”.

Ndërsa neni 23 i ligjit përcakton se “arsimi i mesëm i lartë synon zhvillimin e mëtejshëm të kompetencave të fituara nga arsimi bazë, konsolidimin e individualitetit të çdo nxënësi dhe tërësinë e vlerave e të qëndrimeve, zgjerimin dhe thellimin në fusha të caktuara të dijes, përgatitjen për arsimin tretësor ose për tregun e punës”.

Si çdo sistem arsimor edhe ai parauniversitar publik e ka mision të natyrshëm aftësimin për jetë dhe për punë, duke synuar zhvillimin shoqëror e fizik të nxënësve, por e gjitha kjo edhe nëse evokon në mënyrë tejet të tërthortë idenë e orientimit për karrierën, më së shumti mund të përfaqësojë vetëm atë që quhet edukim për karrierën.

Sikurse përcaktuar në Urdhrin nr. 600, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, miratuar me 19.10.2023, “Orientimi i nxënësve për karrierën realizohet përmes disa fushave të veprimtarive: Informacioni për karrierën; Këshillimi për karrierën; Edukimi për karrierën.”²², ndaj edhe në rastin e interpretimit më elastik të ligjit në fjalë, fusha e fundit e veprimtarive, përfaqëson vetëm një pjesë të pamjaftueshme për realizimin e një game të gjerë veprimtarish të nevojshme për fokusimin e objektivit të orientimit për karrierë të nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar publik.

Pavarësisht referimeve të mësipërme, nga një lexim i kujdesshëm i Ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rezulton se nuk ka asnjë nen, paragraf apo gërmë të tij i cili prek apo trajton në mënyrë të drejtpërdrejtë çështjen

¹⁹ https://www.etf.europa.eu/sites/default/files/2021-09/investing_in_career_guidance.pdf

²⁰ Ligji Nr. 69 i miratuar në datën 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, dhe i ndryshuar me Ligjin nr. 56/2015 dhe Ligjin nr. 48/2018.

²¹ Përgjigje e dhënë Pyetsorit të dërguar nga GA më 31.07.2024

²² Urdher-Nr.600-date-19.10.2023-Per-Miratimin-e-Udhezuesit-te-Orientimit-per-Karrieren-te-Nxenesve-ne-AMU-kl.-6-9.pdf

e orientimit për karrierë të nxënësve, në Sistemin Arsimor Parauniversitar, ndonëse ky është ligji kornizë i këtij sistemi.

Duke mos sanksionuar përcaktime rreth kësaj problematike, ky dokument bazë, lë të papërcaktuar njëherësh: organigramën e strukturave të dedikuara për orientimin në karrierë të nxënësve të arsimit parauniversitar, kufijtë e përgjegjësive institucionale të tyre, terminologjinë e unifikuar, si dhe ligjërimin e kostifikimit të veprimtarive në mbështetje të objektivave të synuar nëpërmjet procesit të orientimit në karrierë.

Për sistemin e arsimit universitar, Ligji 85/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, pasi përcakton qartë se “Institucionet e arsimit të lartë gëzojnë liri akademike, autonomi financiare, organizative”²³, paralelisht sanksionon po aq qartë detyrimin se “Personeli akademik në institucionet e arsimit të lartë kryen veprimtari të mësimdhënies, këshillim për studentët si dhe veprimtari të tjera”²⁴.

Institucionet e arsimit të lartë, për efekt të ligjit kornizë janë ente autonome dhe si të tilla që vetërregullohen, Megjithatë, Ligji 85/2015 nuk heziton t’ua sanksionojë detyrimin e këshillimit të studentëve, sigurisht edhe për nevojat që lidhen me orientimin për karrierë, ndërkohë që Ligji 69/2012, nuk përcakton asgjë rreth detyrimit për orientim për karrierë të nxënësve të institucioneve të arsimit parauniversitar, institucione të cilat nuk gëzojnë asnjë autonomi vetërregulluese.

Ky trajtim i diferencuar i dy sistemeve të arsimit në vendin tonë, atij parauniversitar dhe atij universitar, i bën edhe më të dukshme, heshtjen e legjislatorit rreth çështjes në fjalë dhe mangësitë e Ligjit 69/2012, sa i përket rregullimit të nevojës së nxënësve për orientim për karrierë në sistemin e arsimit parauniversitar, sistem i cili nuk gëzon asnjë lloj autonomie vetërregulluese.

1- Gjetje nga auditimi: Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rezulton se nuk ka asnjë parashikim apo rregullim të drejtpërdrejtë të procesit të orientimit për karrierë të nxënësve në Sistemin Arsimor Parauniversitar.

Konkluzion: Mungesa e parashikimeve në ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, lidhur me procesin e orientimit për karrierë të nxënësve në Sistemin Arsimor Parauniversitar, duke mos përcaktuar: strukturat e dedikuara për menaxhimin e tij, fushën e përgjegjësive të tyre, përdorimin e një terminologjie të unifikuar, detyrimin për kostifikimin e veprimtarive, krijon kushte për administrim joefektiv të këtij procesi.

Observacion i Ministrisë të Arsimit dhe Sportit

Me shkresën e MAS me nr. 5517/2, datë 06.01.2025, protokolluar me tonën nr. prot.766/6, më datë 07.01.2025, janë përcjellë observacionet mbi Projekt Raportin dhe për problematikën e vënë në dukje, konkretisht parashtrohet sa më poshtë:

“Ligji nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, rregullon aspektet e arsimit parauniversitar dhe përfshin dispozita që lidhen me orientimin për karrierën si pjesë e përgjithshme e procesit mësimor-edukativ, por edhe e shprehur në mënyrë të qartë.

Më konkretisht krahas konstatimeve të bëra nga ju, mund të përmendim ndër të tjera edhe pikën 10, të nenit 2, në të cilën koncepti kompetencat themelore përkufizohet si vijon:

²³ Ligji 85/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, paragrafi 1.

²⁴ Ligji 85/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 59, paragrafi 1.

“Kompetenca themelore” është kompetenca, për të cilat kanë nevojë të gjithë individët për plotësim dhe zhvillim vetjak, për qytetari aktive, për përfshirje shoqërore dhe për punësim”. Ky përkufizim është fryma dhe filozofia e Kornizës Kurrikulare Kombëtare, e cila gjithë fokusin e saj e ka tek të mësuarit me kompetenca për të qënë të aftë për jetën. Edhe në pikën 22, të nenit 2, thuhet: “22. “Veprimtari plotësuese” janë veprimtaritë që planifikohen nga institucioni arsimor dhe kanë për qëllim pasurimin e përvojave mësimore e jetësore të nxënësve.”

Gjithashtu në nenin 13, të ligjit 69/2012, në të cilin shtatë kompetencat themelore mbi të cilat organizohet procesi mësimor-edukativ në arsimin parauniversitar, të cilat janë: kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; kompetenca e të menduarit; kompetenca e të mësuarit për të nxënë; kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin; kompetenca personale; kompetenca qytetare; kompetenca digjitale. Nga sa shihet i gjithë fokusi i kurrikulës kombëtare që zbatohet në arsimin parauniversitar ka për qëllim aftësimin dhe përgatitjen e nxënësve për të qënë të aftë për jetën, gjë e cila lidhet edhe me orientimin e tyre për karrierën. Aktualisht në MAS me urdhrin nr. 144, datë 09.04.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për rishikimin e ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është ngritur grupi i punës për rishikimin e ligjit, në të cilin do të merren në konsideratë edhe rekomandimet tuaja.”.

Qëndrimi i Grupit të Grupit të Auditimit:

Lidhur me sa observohet nga ana e MAS, parashtrimet nuk e çënojnë përmbajtjen e gjetjes. Madje fakti që MAS pohon se “është ngritur grupi i punës për rishikimin e ligjit, në të cilin do të merren në konsideratë edhe rekomandimet tuaja (ndr. GA)”, dëshmon se Ministria është e vetëdijshme mbi nevojën e ndryshimeve ligjore. Por vihet në dukje se, në të gjitha komunikimet me MAS, gjatë gjithë fazave të auditimit, Grupit të Auditimit nuk i është bërë me dije miratimi i një urdhri, si ai me nr. 144, datë 09.04.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për rishikimin e ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Për më tepër ky urdhër dhe tani që dërgohet observacioni, nuk i përcillet audituesve, si dokument provues.

Për sa më lart, **observacioni nuk merret në konsideratë.**

1.1 Rekomandimi: Ministri i Arsimit dhe Sportit të ngrejë një grup pune për të analizuar e rishikuar ligjin “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, lidhur me nevojën e rregullimit të procesit të orientimit të karrierës, duke përgatitur amendimet e nevojshme të tij, të cilat të propozohen më tej për miratim.

Brenda vitit 2025

➤ Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026, nuk ka objektiva për procesin e orientimit karrierë të nxënësve, në sistemin arsimor parauniversitar.

Nga studimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 621, i datës 22.10.2021 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021-2026”, konstatohet se ky dokument politik nuk ka asnjë qëllim politik, objektiv kryesor apo specifik, veprimtari kryesore apo specifike që të fokusojë nevojën për orientim për karrierë të nxënësve të sistemit të arsimit parauniversitar publik.

Konstatohet se ndryshe nga sa i dedikohet sistemit të arsimit parauniversitar, për sistemin e arsimit të lartë i cili gëzon autonomi, parashikon në synimin e realizimit e Qëllimit të politikës C: “Arsimi lartë gjithëpërfshirës që përmbush standardet ndërkombëtare të cilësisë, integritetit akademik e transparencës dhe është promotor i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit”, se një ndër masat e nevojshme për arritje e produktit C.3.1: “Harmonizohen programet në IAL me kërkesat e tregut të punës”, është “Krijimi/funksionalizimi i zyrave të karrierës në IAL-të

publike”. Kjo zgjedhje dhe në strategji përforcon idenë se vëmendja është e fokusuar orientimin për karrierë, tek IAL-et dhe aspak tek institucionet e arsimit parauniversitar.

Vizioni politik mbi të cilin është konceptuar “Strategjia e zhvillimit të arsimit parauniversitar 2014-2020”, sa i përket nevojës së orientimit të karrierës, rezulton se ka ndryshuar.

Në “Strategjinë e zhvillimit të arsimit parauniversitar 2014-2020”, me synimin realizimin e Qëllimit të Politikës A. “Përsosja e qeverisjes, e udhëheqjes dhe e menaxhimit të kapaciteteve dhe burimeve”, lidhur me Veprimtarinë A.9. “Koordinohen veprimtaritë ndërmjet udhëheqjeve arsimore të niveleve të ndryshme dhe sektorëve të tjerë”, parashikohet të: “• Organizohen shërbime profesionale të këshillimit dhe të orientimi në karrierë. • Bashkërendohen dhe koordinohen veprimtari me komitetet e prindërve dhe me shoqatat e tjera”.

2- Gjetje nga auditimi: Nga studimi i Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021-2026 dhe feedback-u i marrë nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit gjatë auditimit, konstatohet se ky dokument, nuk përmban asnjë parashikim specifik lidhur me objektivat politike për procesin e orientimit për karrierë të nxënësve, në sistemin arsimor parauniversitar.

Konkluzion: Mungesa e një vizioni politik për orientimin e karrierës të nxënësve në sistemin e arsimit parauniversitar, nuk ka garantuar një administrimin efektiv të këtij procesi.

Observacion i Ministrisë të Arsimit dhe Sportit

Me shkresën e MAS me nr. 5517/2, datë 06.01.2025, protokolluar me tonën nr. prot.766/6, më datë 07.01.2025, janë përcjellë observacionet mbi Projekt Raportin dhe për problematikën e vënë në dukje, konkretisht parashtron sa më poshtë:

“Orientimi për karrierën në SKA 2021-2026, jepet nëpërmjet zhvillimit të kompetencave kyçe të karrierës. Strategjia thekson edukimin e nxënësve për të marrë vendime të bazuara dhe të informuara mbi rrugën e tyre arsimore dhe profesionale. Orientimi i karrierës është pjesë e kompetencave të të nxënësve gjatë gjithë jetës, i integruar në kurrikulën kombëtare dhe proceset e mësimdhënies. Masat dhe aktivitetet për orientimin e karrierës nëpërmjet krijimit të mekanizmave mbështetës, ku institucionet arsimore ofrojnë këshillim profesional për nxënësit. Zhvillimi i burimeve për orientimin profesional, duke përfshirë manuale, platforma digjitale dhe informacione mbi tregun e punës. Partneritetet me aktorë ekonomikë, përmes të cilit bëhet promovimi i bashkëpunimit midis shkollave dhe sektorit privat për të lehtësuar orientimin në karrierë për nxënësit, si dhe organizimi i aktiviteteve si ditë të hapura, vizita në kompani dhe praktika profesionale. Një tjetër aspekt që lidhet me orientimin e karrierës është roli i mësuesve dhe këshilluesve të karrierës, ku parashikohet formim i vazhdueshëm për stafin edukativ që ofron këshillim karriere, përfshirja e këshilluesve të karrierës në hartimin e planeve individuale për nxënësit. Aktualisht dokumenti SKA 2021-2026, është në procesin e vlerësimit të ndërmjetëm nga ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë me mbështetjen e organizatës UNICEF. Rekomandimet e këtij vlerësimi do t’i përcillen grupeve koordinuese, të cilët drejtohen përkatësisht nga zv/ministri përgjegjës për fushën e arsimit parauniversitar dhe zv/ministri përgjegjës për fushën e arsimit të lartë..”.

Qëndrimi i Grupit të Grupit të Auditimit:

Lidhur me sa observohet nga ana e MAS, parashtrimet nuk e çënojnë përmbajtjen e gjetjes. Për sa më lart, **observacioni nuk merret në konsideratë.**

2.1 Rekomandimi: Ministri i Arsimit dhe Sportit të ngrejë grup pune, për përfshirjen dhe miratimin në Strategjinë Kombëtare të Arsimit, të vizionit strategjik të procesit të orientimit për karrierë të nxënësve në arsimin parauniversitar.

Brenda vitit 2025

➤ ***Urdhrrat e miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Sportit me parashikimet për orientimin e karrierës së nxënësve të sistemit të arsimit parauniversitar publik janë të paunifikuara.***

Në Urdhrrin nr. 31, datë 28.1.2020, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, lidhur me veprimtaritë e orientimit për karrierë të nxënësve të arsimit parauniversitar, parashikohet që: “1. Drejtoria e shkollës së arsimit bazë organizon me nxënësit e klasës së nëntë dhe personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të tyre:

a) takime me punonjës arsimorë të shkollave të arsimit të mesëm të lartë;

b) vizita në mjedise të mundshme për punësim.

2. Drejtoria e shkollës së arsimit të mesëm të lartë organizon me nxënësit e vitit të fundit dhe me personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të tyre:

a) takime me pedagogë të degëve të institucioneve të arsimit të lartë;

b) vizita në mjedise të mundshme për punësim”²⁵.

Nga ana tjetër, po i njëjti Urdhër parashikon që: “Mësuesi kujdestar përkujdeset, posaçërisht, për:plotësimin e pëlqimeve të nxënësve për kurrikulën me zgjedhje; këshillimin e nxënësve në zgjedhjet kurrikulare dhe zgjedhjet e karrierës”²⁶.

Ky Urdhër pavarësisht se detyron mësuesin kujdestar të përkujdeset për orientimin në karrierë, për dy aspektet e sipërpërmendura, nuk përcakton asgjë më tej, mbi modalitetet e zhvillimit të kësaj veprimtarie nga ana e tij. Ndërkohë që drejtori i shkollës, në zbatim të këtij Urdhri, ka një rol specifik, sa i përket orientimit për karrierë të nxënësve të arsimit parauniversitar, por vetëm të atyre të klasave të nënta dhe dymbëdhjeta. ndërkohë që për klasat VI, VII, VIII, X, XIX, ai nuk ka asnjë kompetencë. Veç të tjerash në nivel termash të përdorur, ky urdhër flet për këshillim dhe jo për orientimin për karrierë.

Si i tillë Urdhri nr. 31, i miratuar më datë 28.1.2020, mbetet fragmentar dhe i paplotë.

“Udhëzuesi i Orientimit për Karrierën në klasën e 9)”, miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Sportit me Urdhrrin e protokolluar me nr. 246/1, më datë 13.01.2023, në distancë kohorë nga i pari, merr përsipër të fokusohet në orientimin për karrierë të nxënësve të vetëm një klase të arsimit të mesë të ulë, atë të nëntë, duke lënë, jashtë vëmendjes këtë nevojë për klasat e VI, VII, VIII.

Me Urdhrrin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit, Nr. 600, miratuar më 19.10.2023 “Udhëzuesi i Orientimit për Karrierën e Nxënësve në AMU (klasat 6-9)”, përcaktohet në mënyrë të qartë se si duhet të realizohet procesi i orientimit për karrierë të nxënësve në arsimin e mesëm të ulët. Ndërkohë, edhe kjo nismë e MAS, mbetet e pjesshme meqë nuk i shtrin parashikimet e veta në arsimin e mesëm të lartë.

Ndërkaq ndërhyrjet e herëpashershme, me urdhra të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, përveç se kanë lënë të parregulluar për klasat e arsimit të mesëm të lartë, procesin e orientimit për karrierë të nxënësve, ka krijuar edhe probleme me terminologjinë e përdorur në materialet dhe raportet e prodhuara nga institucionet e arsimit parauniversitar.

Nga studimi i akteve, procesit të orientimit për karrierë i referohen si i tillë, vetëm për AMU – në, ndërkohë që për AML – në, i gjithë procesi i orientimit nominalisht, reduktohet në këshillim, kur sikurse u tha më lart, këshillimi është vetëm njëra prej nënveprimtarive të procesit të gjerë të orientimit për karrierë.

Urdhri i Ministrit të Arsimit dhe i Sportit nr. 463, i miratuar më datë 30.08.2024 “Për përcaktimin e kriterëve për miratimin e “Mësuesit Koordinator për Sigurimin e Cilësisë” dhe

²⁵ Urdhri Nr. 31, datë 28.1.2020, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, neni 79.

²⁶ Urdhri Nr. 31, datë 28.1.2020, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, neni 66, paragrafi 3, germat d) dhe e).

të “Mësuesit Koordinator të Këshillimit të Karrierës” në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, përcakton: detyrat e Mësuesit Koordinator për Këshillimin e Karrierës, numrin e nxënësve që duhet të mbulohen prej tyre, kriteret që duhet të plotësojë për të aplikuar, procedurat e përzgjedhjes, veprimtarinë e institucioneve dhe aktorëve të përfshirë gjatë procesit.

Veç të tjerash ky Urdhër parashikon se “Në rast se nuk paraqiten aplikime që përmbushin pikën 14 të këtij urdhri dhe/ose aplikantët nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë urdhër, për këto pozicione mund të aplikojnë mësues me kontratë pune me afat të pacaktuar nën juridiksionin e ZVAP-së përkatëse, në varësi të ngarkesës së tyre mësimore pa cenuar planin lëndor përkatës. *Procedurat e shpalljes për këtë pikë, njoftohen në faqet zyrtare të institucionit që organizon thirrjen për aplikim, sipas procedurës së miratuar nga AKAP*”²⁷.

Duke pasur parasysh se ky urdhër parashikon se “ZVAP organizon procesin e njoftimit, përzgjedhjes për emërimin e mësuesve koordinatorë të sigurimit të cilësisë dhe mësuesve koordinatorë për këshillimin e karrierës, bazuar në procedurën e përcaktuar nga AKAP”, u konstatua që nga ZVAP-et e vizituara në fazën e terrenit, faqe zyrtare dispononte vetëm ZVAP Librazhd dhe ai Tiranë dhe të tjerat nuk kishin, është e qartë se ky parashikim i urdhrit mbetet i pazbatueshëm sot, për shkak të mungesës së infrastrukturës informatike, gjë e cila dëshmon se edhe ky urdhër është ka qenë i paanalizuar në përmbajtjen e tij para miratimit.

3- Gjetje nga auditimi: Lidhur me procesin e orientimit për karrierë të nxënësve në sistemin e arsimit parauniversitar urdhrat e Ministrit të Arsimit dhe Sportit, përkatësisht:

- Urdhrrat nr. 31, datë 28.1.2020, “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë” dhe nr. 600, “Udhëzuesi i Orientimit për Karrierën e Nxënësve në AMU (klasat 6-9)” miratuar më 19.10.2023, nuk janë të plotë, pasi nuk marrin parasysh nevojën e rregullimit të procesit të orientimit të karrierës për arsimin e mesëm të lartë. Po ashtu, këto dy urdhra përdorin terminologji të pa unifikuar, pasi njëri trajton këshillim për karrierë dhe tjetri për orientim për karrierë, ndërkohë që edhe këshillimi është një fushë e veprimtarive të procesit të orientimit të karrierës.

- Urdhri nr. 463, i miratuar më datë 30.08.2024 “Për përcaktimin e kriterëve për miratimin e “Mësuesit Koordinator për Sigurimin e Cilësisë” dhe të “Mësuesit Koordinator të Këshillimit të Karrierës”, është i pazbatueshëm aktualisht për mungesë të infrastrukturës informatike dhe si i tillë rezultoi i pa analizuar paraprakisht në përmbajtjen e tij.

Konkluzion: Miratimi i urdhrave të paanalizuar, të paplotë, me terminologji të paunifikuar dhe të pazbatueshëm për shkak të mungesës së infrastrukturës informatike të nevojshme, bëhet pengesë për një proces efektiv të orientimit për karrierë të nxënësve në sistemin e arsimit.

Observacion i Ministrisë të Arsimit dhe Sportit

Me shkresën e MAS me nr. 5517/2, datë 06.01.2025, protokolluar me tonën nr. prot.766/6, më datë 07.01.2025, janë përcjellë observacionet mbi Projekt Raportin dhe për gjetjen e mësipërme pasi Ministria pranon rekomandimin 3.1, parashtron sa më poshtë:

“Në pikën 4 të nenit 9, përcaktohet se shkollat krahas kurrikulës bërthamë që zbatohet nga të gjithë nxënësit e arsimit bazë në të gjithë vendin, kanë edhe kurrikul me zgjedhje, e cila zgjidhet nga shkolla dhe zhvillohet brenda kohës së planifikuar në planin mësimor, në përputhje me interesat, me nevojat e nxënësve dhe me mundësitë e shkollës. Edhe në pikën 1 të nenit 17-të përcaktohet se drejtorja e shkollës, mësuesit kujdestar, ekipet lëndore informojnë nxënësit për modulet/lëndët me zgjidhje që ofron shkolla, si dhe garanton

²⁷ Urdhri i Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 463, i miratuar më datë 30.08.2024 “Për përcaktimin e kriterëve për miratimin e “Mësuesit Koordinator për Sigurimin e Cilësisë” dhe të “Mësuesit Koordinator të Këshillimit të Karrierës”, pika 15.

zgjedhjen e tyre nga nxënësit. Lëndët me zgjedhje janë një mundësi që nxënësit në bashkëpunim me shkollën kanë për të zgjedhur sipas dëshirave, prirjeve dhe orientimit për karrierën.

Në nenin 26 përcaktohen llojet e veprimtarive plotësuese dhe jashtëshkollore, të cilat planifikohen nga IA-të. Të gjitha këto veprimtari kanë për qëllim jo vetëm argëtimin, konkurrimin dhe promovimin e talentit të fëmijëve në fusha të ndryshme, por edhe evidentimin e prirjeve të veçanta të secilit nxënës, për ta orientuar dhe inkurajuar atë në zhvillimin e karrierës së tij/saj.

Në shkronjën “e”, të pikës 2, të nenit 66, mësuesi kujdestar ngarkohet për këshillimin dhe zgjedhjen e karrierës, kjo krahas detyrave të përgjithshme që ka, të cilat mbështetjen për çdo nxënës në varësi të nevojave dhe aftësive. MAS ka rritur me 2 orë në javë punën e mësuesit kujdestar, duke i krijuar më shumë hapësira për punën me nxënësit, një ndër të cilat janë edhe këshillimi, orientimi, mbështetja personale etj.

Neni 79, i urdhrit të sipërpërmendur “Orientimi i nxënësve për karrierën e tyre” në të cilën përcaktohen strukturat e shkollës për mbështetje dhe orientimin e nxënësve të klasës IX-të të arsimit bazë dhe klasës XII-të të arsimit të mesëm të lartë për orientimin e karrierës nga shkollat.

Krahas këtyre akteve ligjore dhe nënligjore nga MAS janë miratuar dhe funksionojnë disa programe jashtëshkollore që fokusin e tyre është tek aftësimi i nxënësve për jetën nëpërmjet përvojave praktike, siç janë: Nisma Shkolla si Qendër Komunitare, e cila në fokusin e saj kryesor ka veprimtari komunitare të shkollës me fokus veprimtaritë praktike të realizuara nga nxënësit sipas talentit dhe prirjes së secilit në fusha të ndryshme si sipërmarrja, arti, sporti, fusha e biznesit etj., nisma ”Artet dhe Zejet”, nisma ”Toka në shkollë”, klasat sportive etj.

Gjithashtu Ministria e Arsimit dhe Sportit, që prej vitit 2013, nëpërmjet Marrëveshjeve të Bashkëpunimit me Junior Achievement of Albania (JAA) ka prezantuar në sistemin e arsimit parauniversitar në Shqipëri, modulet lëndore të aftësive për sipërmarrjen, edukimin financiar dhe gatishmërinë për punë përmes programeve që mundësojnë zbatimin e njohurive teorike në praktikë.

Konstatimi juaj (faqa 23 e draftit) mendojmë se nuk qëndron. Mësuesi kujdestar i klasës ka detyra specifike me klasën kujdestari një prej të cilave lidhet edhe me orientimin për karrierën. Por, krahas punës që do të bëhet nga mësuesit kujdestar të klasave kujdestari, urdhri ngarkon me këtë detyrë edhe drejtorin e shkollës, si titullari i institucionit që udhëheq dhe menaxhon të gjithë procesin mësimor, edukativ, jashtëshkollor dhe administrativ të shkollës. Në këtë kuptim përcaktimi i orientimit për karrierën e nxënësve nga dy struktura është pozitive për qëllimin e vendosur, që vjen sinkron me gjithë sa sqaruam më lart.

Referuar urdhrit nr. 463, datë 3.08.2024 për mësuesin koordinator të këshillimit të karrierës, struktura e re që është ngritur është mësuesi koordinator i këshillimit të karrierës me përshkrim pune të përcaktuar në këtë urdhër. Kjo strukturë do të vazhdojë të funksionojë për këshillimin e nxënësve për karrierën në AMU dhe AML dhe është mbështetur me Udhëzuesin për mësuesin koordinator të këshillimit të karrierës në AMU dhe Udhëzuesin për mësuesin koordinator të këshillimit të karrierës në AML.

Urdhri nr. 600, datë 19.10.2023 i referohet orientimit për karrierën të nxënësve në AMU, proces i planifikuar të kryhej kryesisht nga mësuesit kujdestarë dhe nga koordinatori, si një strukturë mbështetëse, jo e dedikuar me normë të përcaktuar për këtë qëllim.

Referuar përshkrimit në projekt raportin e auditimit kjo gjetje i referohet procedurave që ZVAP kanë ndjekur për organizimin e procesit të njoftimit, përzgjedhjes për emërimin e mësuesve koordinatorë të këshillimit të karrierës, përmes faqeve zyrtare të institucionit, në zbatim të urdhrit nr. 463.”

Qëndrimi i Grupit të Grupit të Auditimit:

Lidhur me sa observohet nga ana e MAS, parashtrimet nuk e çënojnë përmbajtjen e gjetjes, madje e konfirmojnë, meqë rekomandimi 3.1 (Gjetja nr. 3 deri në fazën e dhënies së mendimeve nga Departamenti i Shqyrtimit, Mbikëqyrjes dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit dhe Zbatimit të Standardeve, pasohej nga dy rekomandime: 3.1, për terminologjinë dhe 3.2, për përgjegjësitë mbi mos zbatueshmë e urdhrave, tashmë të përmbledur në një të vetëm), referuar pikërisht kësaj gjetjeje, pranohet nga subjekti.

Lidhur me përgjegjësitë për moszbatueshmërinë e urdhrave, me objekt procesin e orientimit të karrierës, të nxënësve në arsimin parauniversitar, Grupi i Auditimit specifikisht i referohet Urdhrit nr. 463, i miratuar më datë 30.08.2024 “Për përcaktimin e kriterëve për miratimin e “Mësuesit Koordinator për Sigurimin e Cilësisë” dhe të “Mësuesit Koordinator të Këshillimit të Karrierës”, i cili është i pazbatueshëm për mungesë të faqeve zyrtare (me pak përjashtime) të ZVAP dhe si i tillë rezultoi i paanalizuar paraprakisht në përmbajtjen e tij nga personat që e kanë detyrim këtë proces dhe duhet të mbahen përgjegjës.

Për sa më lart, **observacioni nuk merret në konsideratë.**

3.1 Rekomandimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit të ngrejë grup pune, që të analizojë mospërputhjet e terminologjisë së legjislacionit mbi procesin e orientimit të karrierës të nxënësve në arsimin parauniversitar dhe t’i unifikojë ato, si dhe të ngrejë grup pune, që të monitorojë dhe nxjerrë përgjegjësitë mbi mos zbatueshmërinë e urdhrave me objekt procesin e orientimit të karrierës, të nxënësve në arsimin parauniversitar.

Brenda gjashtëmuorit të parë të 2025

4.2 A realizohet me efektivitet procesi i orientimit për karrierë i nxënësve nga institucionet përgjegjëse të sistemit të arsimit parauniversitar?

Në strukturën dhe organikën e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, miratuar me urdhrin nr. 215, datë 13.12.2023 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”, si dhe në institucionet e varësisë, nuk ka njësi të dedikuara për orientimin e karrierës, gjë e cila pasqyrohet dhe në rregulloret e brendshme të funksionimit të tyre.

Hapat e ndërmarrë nga MAS për fuqizimin e orientimit të karrierës, janë të pabazuara në analiza të thelluara dhe situatën aktuale të sistemit arsimor, reflektuar kjo në ndryshimin e urdhrave për miratimin e udhëzuesit të orientimit të karrierës, dy herë brenda dhjetë muajve, pa një relacion shoqërues. Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS), nuk ka mundur, jo vetëm informimin në rrugë elektronike të nxënësve për marrëveshjet e bashkëpunimit, por nuk ka siguruar edhe informacion në forma të tjera si: publikime/broshura, dosje, lista informacioni, fletëpalosje, etj, për këtë proces. Orientimi për karrierë nuk është përfshirë në faqen zyrtare elektronike të MAS dhe as të institucioneve të varësisë. Mungon një databazë lidhur me orientimin e karrierës.

Në urdhrin nr. 463 datë 30.08.2024, nuk ka një përcaktim të qartë të treguesve të performancës për vlerësimin e punës së mësuesit koordinator në orientimin e karrierës. Procesi i orientimit të karrierës nuk asistohet nga fonde financiare të dedikuara. Sistemi i menaxhimit të informacionit parauniversitar, jo vetëm nuk është bërë funksional, por ka edhe probleme të tjera serioze, meqë: krijimi i tij nuk është i bazuar në ligjin e arsimit parauniversitar, rregullorja e SMIP është në kundërshtim me urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020, rubrika për orientimin e karrierës nuk është bërë aktive, koordinatori për orientimin e karrierës nuk ka akses te fleta orientuese për prindin, nëpërmjet sistemit “e-Albania” nuk konfirmohet marrja e informacionit nga prindi etj.

➤ **Mungojnë njësiti e dedikuara për orientimin e karrierës.**

Sistemi arsimor parauniversitar ka për qëllim krijimin e kushteve dhe mundësive që nxënësit të aftësohen për jetën dhe punën në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore. Veprimtaritë dhe shërbimet e orientimit për karrierën në arsimin parauniversitar mbështesin nxënësit të zhvillojnë kompetencat, të përgatiten për kalimet nga një nivel i arsimit në tjetrin dhe për tregun e punës.

Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS), orientimin për karrierë e ka përfshirë si një nga fushat në kurrikulën e bazuar në kompetenca që zbatohet në arsimin parauniversitar, duke u mundësuar nxënësve të zhvillojnë aftësitë e të nxënësve gjatë gjithë jetës, përfshirë aftësitë e menaxhimit të karrierës.

Ministria e Arsimit dhe Sportit, ka ndërmarrë disa hapa për të ndërgjegjësuar dhe inkurajuar bashkëpunimin e stafëve mësimore me aktorët e tjerë të përfshirë në procesin e orientimit për karrierën, jo vetëm nëpërmjet kurrikulës, por dhe organizimit të trajnimeve/seminareve për stafet mësimore, bashkëpunimit me prindërit dhe komunitetin, partneritetit me sektorin privat dhe organizatat joqeveritare, etj. Ky proces gjithëpërfshirës me veprimtaritë përkatëse në të gjitha nivelet dhe grupet e interesit kërkon struktura dhe kapacitete të përshtatshme për realizimin e tij.

Referuar në sa më sipër, në përgjigjet e pyetësorit MAS shprehet se...“ka inkurajuar krijimin e strukturave të veçanta në shkolla që merren me orientimin e karrierës, si zyra të këshillimit të karrierës etj. Këto struktura ofrojnë mbështetje të vazhdueshme për nxënësit dhe ndihmojnë mësuesit në zbatimin e programeve të orientimit të karrierës”²⁸.

Në strukturën dhe organikën e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, miratuar me urdhrin nr. 215, datë 13.12.2023 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”, nuk ka njësi të dedikuara për orientimin e karrierës, gjë e cila nuk pasqyrohet as në rregulloren e brendshme të institucionit, miratuar me urdhrin nr. 689, datë 15.11.2022 “Për miratimin e rregullores së brendshme të MAS”. Dhe në institucionet e varësisë, Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar, nuk ka njësi të veçanta për orientimin e karrierës, por ky proces realizohet nga punonjës të stafit të caktuar nga eprorët, jashtë përshkrimit të tyre të punës, veprim ky i pabazuar në akte nënligjore dhe administrative.

Në institucionet arsimore për Arsimin e Mesëm të Lartë, nuk ka njësi të veçanta që merren me këshillimin e karrierës, zyra për këshillim karriere, etj., ndërsa për Arsimin e Mesëm të Ulët, periudha pas vitit shkollor 2022-2023, ka filluar të institucionalizohet ky proces me daljen e Urdhrit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 600, datë 19.10.2023²⁹ “Për miratimin e Udhëzuesit të orientimit për karrierën të nxënësve në arsimin e mesëm të ulët” (klasa 6-9), i cili ndihmon dhe përcakton rolet, përgjegjësitë e aktorëve të angazhuar në këtë proces, veçanërisht shkollat dhe institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, për mirëadministrimin e këtij procesi në të gjitha nivelet e hierarkisë.

4- Gjetje nga auditimi: Procesi i orientimit për karrierë i nxënësve nga institucionet përgjegjëse të sistemit të arsimit parauniversitar nuk ka rezultuar efektiv, si pasojë veçanërisht e mungesës së strukturave të dedikuara në institucionet përgjegjëse. Në strukturën dhe organikën e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, miratuar me Urdhrin e Ministrit³⁰, nuk ka njësi të dedikuara për orientimin e karrierës, gjë e cila pasqyrohet dhe në rregulloren e brendshme të

²⁸ Përgjigje pyetësori MAS

²⁹ Urdhër nr. 600, datë 19.10.2023 “Për miratimin e Udhëzuesit të orientimit për karrierën të nxënësve në arsimin e mesëm të ulët” (klasa 6-9).

³⁰ Urdhri i Ministrit nr. 215, datë 13.12.2023 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit

institucionit³¹. Gjithashtu edhe në institucionet e varësisë, Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar, nuk ka njësi të veçanta për orientimin e karrierës, por ky proces realizohet nga punonjës të stafit të caktuar nga eprorët, jashtë përshkrimit të tyre të punës. Në institucionet arsimore të arsimit të mesëm të lartë, nuk ka struktura të posaçme të angazhuara me administrimin e procesit të orientimit të karrierës, ndërsa në Arsimin e Mesëm të Ulët ka filluar të institucionalizohet ky proces me daljen e Urdhrit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 600, datë 19.10.2023³².

Konkluzion: Në mungesë të njësive të dedikuara, të mësuesit koordinator, procesi i orientimit të karrierës është kryer në mënyrë spontane, gjë e cila ka sjellë mbingarkesë të punonjësve të sistemit arsimor parauniversitar dhe moseficiencë në punë.

Observacion i Ministrisë të Arsimit dhe Sportit

Me shkresën e MAS me nr. 5517/2, datë 06.01.2025, protokolluar me tonën nr. prot.766/6, më datë 07.01.2025, janë përcjellë observacionet mbi Projekt Raportin dhe për problematikën e vënë në dukje konkretisht, parashtrohet sa më poshtë:

“Lidhur me rekomandimin 4.1, ju informojmë se MAS nëpërmjet urdhrit nr. 463, datë 30.08.2024 “Për përcaktimin e kriterëve për miratimin e “mësuesit koordinator për sigurimin e cilësisë dhe të mësuesit koordinator të këshillimit të karrierës” në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar”, ka krijuar një figurë të dedikuar për orientimin e karrierës duke përcaktuar edhe detyrat, përgjegjësitë dhe kriteret për mësuesin koordinator të këshillimit të karrierës.”

Qëndrimi i Grupit të Grupit të Auditimit:

Lidhur me sa observohet nga ana e MAS, parashtrohet nuk përcjellin informacion shtesë, i cili mund të cënonte përmbajtjen e gjetjes.

Për sa më lart, **observacioni nuk merret në konsideratë.**

4.1 Rekomandimi: Ministria e Arsimit dhe e Sportit të marrë masat për ngritjen e njësive të dedikuara për orientimin e karrierës në të gjitha nivelet e sistemit arsimor parauniversitar.

Brenda vitit 2025

➤ *Procesi i orientimit të karrierës nuk është përmirësuar dhe fuqizuar mjaftueshëm.*

Gjatë periudhës objekt auditimi (2021-2024) këshillimi i karrierës ka qenë i realizuar vetëm në Arsimin e Mesëm të Lartë dhe veprimtaritë në zbatim të tij janë zhvilluar bazuar në disa akte nënligjore që kanë të bëjnë me menaxhimin e procesit arsimor në tërësi, jo si prioritet, konkretisht në: urdhrat për Maturën Shtetërore dhe Provimet Kombëtare të Arsimit Bazë, Urdhri nr. 31, datë 28.01.2020 “Për Miratimin e Rregullores së Funkcionimit të Institucionit Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; VKM nr. 78, datë 08.02.2006 “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta”, i ndryshuar; Udhëzimet e përbashkëta midis Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për vitet shkollore 2021-2024 në sistemin arsimor parauniversitar³³, VKM nr. 99, datë 27.2.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, i ndryshuar etj.

³¹ Miratuar me Urdhër nr. 689, datë 15.11.2022 “Për miratimin e rregullores së brendshme të MAS.

³² Urdhër nr. 600, datë 19.10.2023, për Miratimin e “Udhëzuesit të orientimit për karrierën të nxënësve në arsimin e mesëm të ulët” (klasa 6-9).

³³ Udhëzimet e Përbashkëta Nr. 15, datë 24.07.2023, për vitin shkollore 2023-2024 në sistemin arsimor parauniversitar midis MAS dhe MFE.

Referuar në sa më sipër, si dhe në zbatim të urdhrave dhe porosive të eprorëve, punonjësit e caktuar si koordinator në institucionet arsimore të arsimit të mesëm të lartë, janë marrë me hartimin e planeve vjetore dhe kalendarëve të veprimtarive, monitorimin dhe raportimin e realizimit të tyre, por jo në mënyrë specifike, por në kuadër të menaxhimit të procesit mësimor. Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) me Urdhrin nr. 715, datë 1.12.2022, "Për ngritjen e grupit të punës për zhvillimin e procesit të këshillimit dhe orientimit të karrierës në sistemin arsimor parauniversitar", ngriti grupin e punës për zhvillimin e këshillimit të karrierës.

Në zbatim të urdhrit të sipërcituar, Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) në bashkëpunimin me Agjencinë Kombëtare të Sigurimit të Cilësisë të Arsimit Parauniversitar (ASCAP) dhe Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar (AKAP), hartuan Udhëzuesin e orientimit për karrierën, i miratuar nga MAS, me Urdhër nr. 600, datë 19.10.2023, për Miratimin e "Udhëzuesit të orientimit për karrierën të nxënësve në arsimin e mesëm të ulët" (klasa 6-9).

Me miratimin e Urdhrit nr. 246/1 prot., datë 13.01.2023 "Për miratimin e udhëzuesit të orientimit për karrierë në klasën e 9-të", Urdhrit nr. 43, datë 28.02.2023 "Për ngritjen e grupeve të punës për monitorimin e IAP-ve për marrjen e masave për MSH dhe PKAB 2023 dhe orientimin për karrierën", Urdhrit nr. 600, datë 19.10.2023 "Për miratimin e Udhëzuesit të Orientimit për Karrierën të Nxënësve në Arsimin e Mesëm të Ulët (klasa 6-9)", si dhe Urdhrit nr. 463, datë 30.08.2024 "Për përcaktimin e kriterëve për miratimin "mësuesit koordinator për sigurimin e cilësisë" dhe "mësuesit koordinator të këshillimit të karrierës në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar", orientimi për karrierë i nxënësve në klasën e 6-të dhe të 9-të ka filluar në vitin shkollor 2022-2023 dhe vijim, ndërsa në vitin shkollor 2024-2025 do të vijojë edhe në klasën e 7-të dhe të 8-të.

Me miratimin e urdhrave të sipërpërmendur, gjatë periudhës së auditimit, Ministria e Arsimit dhe Sportit ka ndërmarrë hapat për fuqizimin e orientimit për karrierën në institucionet arsimore të arsimit bazë dhe arsimin e mesëm të lartë, veçanërisht për klasat e 9-ta, por kjo e pabazuar në analiza të thelluara dhe situatën aktuale të sistemit arsimor, gjë e cila reflektohet në ndryshimin e urdhrave për miratimin e udhëzuesit të orientimit të karrierës dy herë brenda dhjetë muajve, pa një relacion shoqërues, gjë e cila ka ndikuar në efektivitetin e procesit. Nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), me mbështetjen e UNICEF Shqipëri, në kuadër të projektit "Qëndro" të financuar nga Qeveria Italiane, Tiranë, Qershor 2022, është hartuar raporti "Analiza e orientimit të nxënësve për karrierën në arsimin parauniversitar", por dhe ky bazuar dhe fokusuar mbi kurrikulën për këshillimin e karrierës.

Gjatë periudhës objekt auditimi, në dy raportet e monitorimit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar përcjellë në MAS me shkresën nr. 1944 prot., datë 10.07. 2023 dhe shkresën nr. 267/9, datë 2024, nuk ka një analizë konkrete për ecurinë e procesit të orientimit të karrierës, me synim përmirësimet ligjore dhe reflektimin sugjerimeve të ardhura nga institucionet për një menaxhim më të mirë të procesit.

Pavarësisht hapave të bërë drejt fuqizimit të procesit të orientimit të karrierës në të gjitha nivelet e sistemit të arsimit parauniversitar, konstatohet se gjatë periudhës objekt auditimi, numri i nxënësve që kanë mbaruan klasë e nëntë dhe janë regjistruan në gjimnaze, vazhdon të jetë në rënie, sikurse edhe numri i nxënësve që ndjekin arsimin e lartë.

Ndërkohë konstatohet një rritje e lehtë e numrit të nxënësve që ndjekin arsimin e mesëm profesional, sikurse nga të dhënat e mëposhtme:

Tabela Nr. 4: Të dhëna për vazhdimin e arsimit nga AMU, drejt arsimit profesional, gjimnazit dhe IAL-eve

Nr.	DRAP	Vitet shkollore	Nxënës që përfunduan klasën e IX	Nxënës që vazhduan arsimin profesional	Nxënës që vazhduan gjimnazin	Nxënës që përfunduan klasën e XII	Nxënës që vazhduan IAL
1	Durrës	2021-2022	14017	2303	12939	11546	4550
2	Durrës	2022-2023	13384	2208	12379	10469	4185
3	Durrës	2023-2024	13396	2485	12005	10769	4035
4	Fier	2021-2022	5130	715	3981	3993	3246
5	Fier	2022-2023	4881	876	3846	3764	3147
6	Fier	2023-2024	4733	919	3691	3597	3052
7	Korçë	2021-2022	6196	871	5172	5413	3861
8	Korçë	2022-2023	5814	964	4776	4862	3638
9	Korçë	2023-2024	5626	1157	4446	4961	3694
10	Lezhë	2021-2022	4539	251	4054	3897	2676
11	Lezhë	2022-2023	4301	286	3788	3520	2555
12	Lezhë	2023-2024	3896	451	3309	3239	2479
Gjithsej			85.913	13.486	74.386	70.030	41.118

Burimi: Të dhëna vënë dispozicion nga AKAP


Të dhënave të mësipërme u mungon informacioni nga ZVAP Tiranë lidhur me numrin e nxënësve që kanë vazhduar Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL) për të tre vitet në fokus auditimi, pasi “ZVAP Tiranë nuk disponon të dhëna në lidhje me numrin e nxënësve që kanë vazhduar Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL) për të 3 vitet e kërkuara. Ky informacion nuk është pjesë e raporteve të përditshme dhe nuk është administruar nga institucioni i tyre”³⁴.

Gjithashtu, nga ZVAP Tiranë raportohet se, shifrat e nxënësve që kanë përfunduar klasën e IX nuk kanë përputhshmëri me numrin e nxënësve që kanë vazhduar shkollën profesionale dhe gjimnazin, për shkak të lëvizjes së nxënësve nga qyteti, fëmijë të kthyer nga emigracioni, si dhe përfshirja e nxënësve part-time”³⁵.

³⁴ E- mail i AKAP i datës 2 tetor 2024


³⁵ E- mail i AKAP i datës 2 tetor 2024

Figura Nr. 6: Të dhëna për vazhdimin e arsimit nga AMU, drejt arsimit profesional, gjimnazit dhe IAL-eve, DRAP Durrës




Burimi: Të dhëna të përpunuara nga grupi i auditimit

Figura Nr. 7: Të dhëna për vazhdimin e arsimit nga AMU, drejt arsimit profesional, gjimnazit dhe IAL-eve, DRAP Fier




Burimi: Të dhëna të përpunuara nga grupi i auditimit

Figura Nr. 8: Të dhëna për vazhdimin e arsimit nga AMU, drejt arsimit profesional, gjimnazit dhe IAL-eve, DRAP Korçë



Burimi: Të dhëna të përpunuara nga grupi i auditimit

Figura. 9 Të dhëna për vazhdimin e arsimit nga AMU, drejt arsimit profesional, gjimnazit dhe IAL-eve, DRAP Lezhë



Burimi: Të dhëna të përpunuara nga grupi i auditimit

5- Gjetje nga auditimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit ka ndërmarrë hapa për fuqizimin e orientimit të karrierës në shkolla, por të pabazuara në analiza të thelluara dhe situatën aktuale të sistemit arsimor, reflektuar kjo në ndryshimin e Udhëzuesit për orientimin e karrierës, dy herë brenda dhjetë muajve, si dhe miratimin e Urdhrit nr. 463, datë 30.08.2024 “Për përcaktimin e kriterëve për miratimin “mësuesit koordinator për sigurimin e cilësisë” dhe “mësuesit koordinator të këshillimit të karrierës në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar”, pa një relacion shoqërues.

Gjatë periudhës objekt auditimi, numri i nxënësve që kanë mbaruan klasë e nëntë dhe janë regjistruar në gjimnaze, vazhdon të jetë në rënie, sikurse edhe numri i nxënësve që ndjekin arsimin e lartë. Ndërkohë, konstatohet një rritje e lehtë e numrit të nxënësve që ndjekin arsimin e mesëm profesional, sikurse pasqyrohet në të dhënat e mësipërme.

Konkluzion: Në mungesë të analizave nga institucionet qendrore dhe institucionet e varësisë, fuqizimi/ndërgjegjësimi i procesit të orientimit të karrierës është kryer pjesërisht dhe pa qasje analitike të tij, gjë e cila ka gjeneruar një proces formal.

Observacion i Ministrisë të Arsimit dhe Sportit

Me shkresën e MAS me nr. 5517/2, datë 06.01.2025, protokolluar me tonën nr. prot.766/6, më datë 07.01.2025, janë përcjellë observacionet mbi Projekt Raportin dhe për problematikën e vënë në dukje konkretisht, parashtrohet sa më poshtë:

“Lidhur me pikën 5, bazuar edhe në Udhëzimin e Përbashkët nr. 15, datë 10.07.2023 “Për Vitin shkollor 2023-2024 në sistemin arsimor parauniversitar”, AKAP ka raportuar në MAS në mënyrë periodike, lidhur me ecurinë e zbatimit të Urdhrit nr. 600, datë 19.10.2023 “Për miratimin e udhëzuesit të orientimit për karrierën të nxënësve në arsimin e mesëm të ulët (klasat 6-9). Në bashkëpunim të ngushtë me AKAP dhe ASCAP është realizuar trajnimi i specialistëve të caktuar si koordinatorë të orientimit të karrierës pranë DRAP-eve dhe ZVAP-eve, trajnimi i mësuesve kujdestarë dhe drejtuesve të institucioneve arsimore.

Bazuar në raportet e AKAP dhe ASCAP, me qëllim përmirësimin e orientimit të nxënësve dhe mbështetjes së tyre në zgjedhjen e studimeve apo karrierës, MAS propozoi futjen e dy roleve të reja miratuar me Urdhrin nr. 463, datë 30.08.2024 “Për përcaktimin e kriterëve për miratimin e mësuesit koordinator për sigurimin e cilësisë dhe mësuesit koordinator të këshillimit të karrierës në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar.”.

Qëndrimi i Grupit të Grupit të Auditimit:

Lidhur me sa observohet nga ana e MAS, parashtimet nuk përcjellin informacion shtesë, i cili mund të cënonte përmbajtjen e gjetjes.

Për sa më lart, **observacioni nuk merret në konsideratë.**

5.1 Rekomandimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit të analizojë ecurinë e procesit të orientimit të karrierës mbi bazën e raporteve të institucioneve të varësisë, me synim fuqizimin e tij.

Brenda gjashtëmuajorit të parë të 2025

➤ Mungon informimi, si nevojë e procesit të orientimit të karrierës.

Orientimi për karrierën si një term gjithëpërfshirës përbëhet nga dy elementë kryesorë: edukimi për karrierën dhe këshillimi për karrierën. Të dy këta elementë përfshijnë informimin për karrierën, si një element i tretë i orientimit të nxënësve për karrierë. Ndërsa edukimi për karrierën është pjesë e kurrikulës së shkollës, këshillimi për karrierën përqendrohet në trajtimin dhe kapërcimin e sfidave që ka individit. Informimi për karrierën është një nga komponentët më të rëndësishme të procesit të orientimit, pasi përfshin informacionin rreth institucioneve arsimore të arsimit të mesëm të lartë dhe shtigjeve të karrierës që lidhen me ndjekjen e tyre,

fushave të studimit dhe mundësive që ato ofrojnë për punësim dhe avancim në karrierë, rreth profesioneve dhe drejtimeve të mundshme të karrierës etj.

Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS), si institucion përgjegjës për orientimin e karrierës, ka për detyrë të sigurojë të gjitha kushtet më të domosdoshme dhe optimale për informimin e nxënësve, përmes sistemit arsimor dhe partneriteteve me aktorë, institucione e autoritete të tjera shtetërore, kombëtare e vendore. Ministria e Arsimit dhe Sportit duhet të mundësojë në të gjitha format dhe mënyrat realizimin e këtij procesi, si: marrëveshje bashkëpunimi, informacion nga publikime/broshura, dosje, lista informacioni, fletëpalosje etj. dhe gjithçka të bëhet publike nëpërmjet komunikimit elektronik, faqeve zyrtare.

Referuar në sa më sipër konstatohet se, MAS ka nënshkruar marrëveshje me Bashkinë e Tiranës me nr. 2996/2 prot., datë 05.05.2022 dhe nr. 5460/1 prot., datë 27.04.2022 “Marrëveshje bashkëpunimi për këshillimin e karrierës për nxënësit e arsimit parauniversitar”, e cila është përshirë dhe në udhëzimet e viteve shkollorë 2022-2023, 2023-2024, dhe një marrëveshje me Ministrinë e Mbrojtjes me nr. 5666/2 prot., dhe nr. 3921/ 5 prot., datë 02.09.2024, për edukim patriotik dhe atdhetar të të rinjve në kuadër të programit “Bëhu pjesë e Forcave të Armatosura”. Ministria nuk ka asnjë marrëveshje tjetër me partner ose aktorë të tjerë, në mbështetje të procesit të orientimit të karrierës, kur në raportin e analizës së bërë në vitin 2022 me UNICEF, kjo qasje konsiderohet si një formë e rëndësishme për informimin e nxënësve në shkolla.

Për këshillimin e karrierës planifikohen dhe aktivitete me IAL-të, ditët e këshillimit të karrierës. Në këtë proces, tashmë të legjitimuar, interesi parësor është i institucioneve të arsimit të lartë, për të patur kuota të mjaftueshme për programe studimi, dhe jo përzgjedhja e nxënësve sipas prirjeve dhe aftësive.

Për sa konstatuar në fazë terreni, në mungesë të rubrikës dhe të dhënave për organizimin dhe zbatimin e veprimtarive për orientimin e karrierës në faqen zyrtare elektronike të MAS, ZVAP-e dhe IAP-e, nxënësit dhe aktorët e tjerë të përfshirë në proces, nuk marrin informacion të drejtpërdrejtë lidhur me orientimin për karrierë.

6- Gjetje nga auditimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit, si institucion përgjegjës për orientimin e karrierës, nuk ka mundur, jo vetëm informimin në rrugë elektronike të nxënësve për marrëveshjet e bashkëpunimit, por nuk ka siguruar edhe informacion në forma të tjera si: publikime/broshura, dosje, lista informacioni, fletëpalosje, etj. Orientimi për karrierë nuk është përfshirë në faqen zyrtare elektronike të MAS dhe as të institucioneve të varësisë. Nuk ka një databazë lidhur me orientimin e karrierës, organizimin dhe zbatimin e veprimtarive për drejtoritë e institucioneve arsimore.

Konkluzion: Mungesa e rubrikës dhe të dhënave për organizimin dhe zbatimin e veprimtarive për orientimin e karrierës në faqen zyrtare elektronike të MAS, si dhe ZVAP e IAP, sjell mungesë në informimin e të rinjve në kohë përgjatë procesit të vendimmarrjes së tyre lidhur me karrierën.

Observacion i Ministrisë të Arsimit dhe Sportit

Me shkresën e MAS me nr. 5517/2, datë 06.01.2025, protokolluar me tonën nr. prot.766/6, më datë 07.01.2025, janë përcjellë observacionet mbi Projekt Raportin dhe për problematikën e vënë në dukje konkretisht, parashtrohet sa më poshtë:

“Lidhur me rekomandimin 6.1, bazuar në Urdhrin nr. 463, datë 30.08.2024 ”Për përcaktimin e kriterëve për miratimin e ”mësuesit koordinator për sigurimin e cilësisë dhe të mësuesit koordinator të këshillimit të karrierës” në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar”, mësuesi koordinator për këshillimin e karrierës harton planin e orientimit dhe këshillimit të karrierës për nxënësit në shkolla, i orienton për ndjekjen e niveleve të arsimit sipas prirjeve dhe talenteve të secilit.”.

Qëndrimi i Grupit të Grupit të Auditimit:

Lidhur me sa observohet nga ana e MAS, parashtrimet nuk përcjellin informacion shtesë, i cili mund të cënonte përmbajtjen e gjetjes.

Për sa më lart, **observacioni nuk merret në konsideratë.**

6.1 Rekomandimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe institucionet e varësisë të marrin masat për funksionimin e rubrikës për orientimin e karrierës në faqet zyrtare elektronike të tyre dhe publikimin e të dhënave për organizimin dhe zbatimin e veprimtarive lidhur me të, si një domosdoshmëri për informimin e të rinjve në kohë përgjatë procesit të vendimmarrjes lidhur me karrierën, duke garantuar edhe forma të tjera publikimi.

Brenda gjashtëmuajt të parë të 2025

➤ ***Problematikat me Koordinatorin për Orientimin e Karrierës dhe Mësuesin Koordinator të Këshillimit të karrierës.***

Në pikën 7, të Udhëzuesit të orientimit për karrierën në arsimin e mesëm të ulët (klasa 6-9), përcaktohet roli i koordinatorit të DRAP/ ZVAP /AKAP dhe IAP.

Koordinatori i institucionit arsimor parauniversitar harton planin vjetor të veprimtarive të institucionit arsimor për orientimin për karrierën, përgatit raportin 3-mujor të ecurisë së zbatimit të veprimtarive për orientimin për karrierën dhe ia dërgon drejtorisë së institucionit arsimor . Koordinatori krijon databazën me të dhënat e mbledhura nga gjurmimi i tyre, të cilat i dorëzon në ZVAP. Monitoron daljen (tranzicionin) e nxënësve nga klasa e 9-të dhe mbledh informacion për drejtimin që ndjekin nxënësit që mbarojnë klasën e 9-të.

Sa konstatuar në terren dhe intervistat e bëra rezultoi se disa institucione arsimore parauniversitare ka plane të orientimit të karrierës, por këto janë formale, me një gamë të gjerë aktivitetesh dhe të parakorduara me planet vjetore të shkollës. Planet vjetore të veprimtarive të IAP-ve si dhe dërgimi i tyre në ZVAP-et dhe DRAP-et përkatëse është bërë para miratimit të Urdhrit nr. 600, datë 19.10.2023, për miratimin e “Udhëzuesit të orientimit për karrierën të nxënësve në arsimin e mesëm të ulët (klasa 6-9)”, Po ashtu nuk është funksional data baza e nxënësve përcjellë nga ZVAP dhe IAP-et. Ndërkohë nuk ka një informacion të detajuar pranë ZVAP-ve me relacionet përshkruese dhe fead back për realizmin e tyre.

Deri në miratimin e Urdhrit nr. 463, datë 30.08.2024 “Për përcaktimin e kriterëve për miratimin “Mësuesit koordinator për sigurimin e cilësisë” dhe “Mësuesit koordinator të këshillimit të karrierës në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar”, drejtori i institucionit arsimor cakton koordinatorin e orientimit për karrierën dhe raportin në ZVAP-et përkatëse. Koordinatori i institucionit arsimor për orientimin për karrierën mund të jetë një nga drejtuesit e institucionit arsimor, mësuesi kujdestar ose mësuesi koordinator i qeverisë së nxënësve ose mësuesi që merret me veprimtaritë artistike në shkollë.

Nga intervistat e kryera me drejtues dhe punonjësit e sistemit arsimor, rezultoi se figura më e përshtatshme për ushtrimin e rolit të koordinatorit për karrierën në IAP (AMU dhe AML) ka qenë mësuesi kujdestar, pasi ai është një njohës i mirë i aftësive, prirjeve dhe mundësive të orientimit të nxënësve, përfshin në planin vjetor të orëve të kujdestarisë tema/veprimtari me nxënësit që mbështesin edukimin dhe orientimin për karrierën, dhe së fundmi ka akses në rubrikën për këshillimin e karrierës në sistemin SMIP. Në raportin e analizës së bërë me UNICEF-2022³⁶, “Raport i analizës së orientimit të nxënësve për karrierën në arsimin parauniversitar”, mësuesi kujdestar përcaktohet si figura më e përshtatshme e stafit mësuesor që mund të sigurojë mbështetje më të kualifikuar për orientimin e nxënësve për karrierën. Por dhe pse kanë kaluar dy vite, ky vlerësim nuk është marrë në konsideratë, për t’a

³⁶ Raport-i-analizës-së-orientimit-për-karrierën-në-arsimin-parauniversitar-1-1-1.pdf

institucionalizuar në të gjitha nivelet e sistemit arsimor, por mësuesi kujdestar dhe cilido anëtar i stafit mësimor në rolin e koordinatorit ka qenë i mbingarkuar në realizimin e këtij funksioni. Veç të tjerash ky raport vë në dukje se rolin e koordinatorit mund t'a luajnë më mirë mësuesit që specializohen për orientim karriere.

Kjo konkretisht është dhe praktika tashmë e konsoliduar e vendeve të cilat e konsiderojnë të rëndësishëm këtë proces, duke e rregulluar formalisht profesionin e orientuesit të karrierës³⁷.

Meqenëse në kuadrin rregullator, për periudhën objekt auditimi 2021-2024, nuk ka përcaktime të qarta mbi kriteret e përzgjedhjes së koordinatorit, në të gjitha nivelet, zgjedhja e tij në AML është bërë mbi bazën e një vlerësimi perceptiv, i pabazuar në një analizë më të thelluar të aftësive profesionale dhe menaxheriale, komunikimit, kualifikimit, bashkëpunimit, etj. Në caktimin e koordinatorëve në IAP, nuk është marrë në konsideratë ngarkesa e tyre në tërësinë e menaxhimit të procesit mësimor, gjë e cila ka çuar në mbingarkesë dhe pamundësi për realizimin e detyrave, brenda afateve ligjore të përcaktuara. Koordinatorët e këshillimit të karrierës, janë të përfshirë në shumë angazhime paralele dhe mënyra e kërkimit me urgjencë të informacioneve nga institucionet e prore, krijon kushte për një informacion të paverifikuar dhe paanalizuar. Mbështetja me trajnime, materiale burimore, kapacitete njerëzore dhe logjistike për orientimin e karrierës janë të pamjaftueshme për realizimin me standardet e synuara të procesit. Për të mos përmendur që kjo është dhe një punë e papaguar dhe e pamotivuar në asnjë aspekt.

Nga informacioni i marrë nga AKAP, numri i mësuesve koordinatorë për periudhën 2023-2024 është 830 në total për AMU. Tabela e koordinatorëve të orientimit për karrierë e gjeni bashkëlidhur projektraportit në shtojcën nr. 1.

Me miratimin e urdhrin nr. 463 datë 30.08.2024, ku përcaktohen kriteret e përzgjedhjes së “Mësuesi koordinatorë”, në AMU dhe AML, numri i tyre është 320³⁸, sa deklaruar nga MAS më datë 17.09.2024.

Në informacionin e përcjellë nga AKAP, me emailin e datës 2.10.2024, citohet: “Për sa i përket informacionit mbi të dhënat e mësuesit koordinator të orientimit, ju bëjmë me dije se Zyrat Vendore Arsimore Parauniversitare, janë ende në proces të finalizimit të përzgjedhjes së tyre”³⁹. Referuar në sa më sipër, deklarata mbi numrin prej 320 koordinatorësh të karrierës, të cilët do të emërohen në AMU dhe AML, duke i paraprirë procesit të përzgjedhjes dhe emërimit të tyre, i papërfunduar akoma më datë 02 tetor 2024, rezultojnë të jetë të pastudiuara dhe analizuar në kushtet aktuale të IAP-ve.

Në pikën 12 të Urdhrit të sipërpërmendur citohet: “.....Në fund të periudhës 3-vjeçare ZVAP-et bëjnë vlerësimin e performancës së tyre, në bazë të të cilit përcaktohet vijimi i punës në rolin e koordinatorit apo rikthimi në pozicionin e mësuesit brenda ZVAP-it”.

Mospërcaktimi i qartë i treguesve të performancës për vlerësimin e punës së mësuesit koordinator sjell pasiguri jo vetëm në fazën e aplikimeve, por dhe për perspektivat e punësimit në vijim, pas vitit të tretë të punës.

Nga intervistat e zhvilluara në terren rezultoi se aplikimet e mësuesve kandidatë për rolin e koordinatorit të orientimit në shkolla kanë qenë të pakta⁴⁰.

Në informacionin e vënë në dispozicion, ka raporte trajnimi të koordinatorëve, ka raporte monitorimi, por ka ndonjë raport specifik lidhur me vlerësimin e performancës së punës së koordinatorëve, qoftë në DRAP dhe ZVAP, apo dhe shkolla.

AKAP ka përcjellë raportet 3 mujore të orientimit të karrierës në MAS, si dhe raportin vjetor për vitin 2023-2024, ku janë përcaktuar konkluzionet dhe rekomandimet e nxjerra, në të cilat

³⁷ <https://onlinecounselingprograms.com/become-a-counselor/counseling-careers/career-counselor/>

³⁸ <https://arsimi.gov.al/320-mesues-te-dedikuar-per-keshillimin-e-karrieres-manastirliu-element-kyc-per-evidentimin-e-prirjeve-dhe-orientimin-e-nxenesve-drejt-arsimit-profesional/>

³⁹ Email i datës 02.10.2024 nga AKAP.

⁴⁰ Intervistat me ZVAP dhe shkollat.

shprehen se ky proces nevojë për përmirësim, por nga ana e MAS nuk ka ndonjë feedback për këtë punë.

Në urdhrin nr. 463 datë 30.08.2024, nuk ka një përcaktim të qartë të treguesve të performancës për vlerësimin e punës së mësuesit koordinator në orientimin e karrierës.

Referuar ndryshimeve ligjore, lidhur me koordinatoren për orientimin e karrierës në AMU dhe AML, nuk është bërë përzgjedhja e tyre, nuk janë rishikuar planet vjetore dhe ato të orientimit të karrierës, ngarkesa mësimore dhe gjithçka që lidhet me menaxhimin e procesit mësimor në kushtet aktuale të sistemit arsimor.

Përcaktimi i koordinatoreve i pabazuar në një akt nënligjor, ka sjellë mbingarkesë të punës së tyre lidhur me procesin e hartimit, rakordimit të planeve vjetore me planet e veprimtarive për orientimin e karrierës, si dhe mosmiratimin në kohë të tyre, duke cenuar efektivitetin e procesit. Mospërcaktimi i qartë i treguesve të performancës për vlerësimin e punës së mësuesit koordinator në orientimin e karrierës në urdhrin nr. 463 datë 30.08.2024, ka nxitur pasiguri jo vetëm në fazën e aplikimeve, por dhe për perspektivat e punësimit në vijim, pas vitit të tretë të punës.

Observacion i Ministrisë të Arsimit dhe Sportit

Me shkresën e MAS me nr. 5517/2, datë 06.01.2025, protokolluar me tonën nr. prot.766/6, më datë 07.01.2025, janë përcjellë observacionet mbi Projekt Raportin dhe për problematikën e vënë në dukje konkretisht, parashtrohet sa më poshtë:

“Lidhur me gjetjen nga auditimi 7.1 se “Në Urdhrin nr. 463, datë 30.08.2024, nuk ka një përcaktim të qartë të treguesve të performancës për vlerësimin e punës së mësuesit koordinator në orientimin për karrierën”, sqarojmë se Urdhri nr. 463 ka përcaktuar kriteret bazë që duhet të plotësojnë mësuesit koordinatorë të këshillimit të karrierës për t’u përzgjedhur si të tillë, ndërsa në përmbushje të pikës 11 të këtij urdhri, treguesit e performancës për vlerësimin e punës së mësuesit koordinator janë përgatitur nga ASCAP.

Këta tregues janë përfshirë në Udhëzuesin për mësuesin koordinator të këshillimit të karrierës në Arsimin e Mesëm të Ulët (AMU) dhe në Udhëzuesin për mësuesin koordinator të këshillimit të karrierës në Arsimin e Mesëm të Lartë (AML), të cilët iu janë shpërndarë institucioneve arsimore parauniversitare përmes Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP), gjatë muajit tetor 2024 dhe janë publikuar në faqen web të ASCAP në linkun: <https://www.ascap.edu.al/udhezuesi-per-koordinatorin-e-karrieres-amu/>; <https://www.ascap.edu.al/udhezuesi-per-koordinatorin-e-karrieres-aml/>.”.

Observacion i Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar

Me shkresën e ASCAP me nr. 1019/1, datë 19.12.2024, protokolluar me tonën nr. prot.766/5, më datë 19.12.2025, është përcjellë vetëm një observacion mbi Projekt Raportin dhe specifikisht për gjetjen 7.1, me të njëjtën përmbajtje sikurse ai i dërguar nga MAS.

Qëndrimi i Grupit të Grupit të Auditimit:

Lidhur me sa observohet nga ana e MAS dhe ASCAP, ku vihet në dukje se, treguesit e performancës për vlerësimin e punës së mësuesit koordinator në orientimin për karrierën janë miratuar në muajin tetor 2024 (pas përfundimit të fazës së terrenit të auditimit në fjalë) dhe këto janë publikuar në faqen web të ASCAP, Grupi i Auditimit vlerëson që **observacioni të merret në konsideratë**, duke mbetur gjetja pa fushë zbatimi rekomandimi.

➤ Mungojnë fondet financiare të dedikuara për procesin e orientimit të karrierës.

Procesi i orientimit për karrierë kërkon fonde financiare, bazë logjistike si dhe kapacitete njerëzore të nevojshme në nivel lokal dhe rajonal. Në Urdhrin nr. 600/2023, janë parashtuar

disa aktivitete, realizimi i të cilave duhet parashikuar në planin e veprimtarive, si: java/ditët e karrierës, panairi i profesioneve, takime me profesionistë të fushave të ndryshme, vizita të mbikëqyrura në institucione të ndryshme të arsimit dhe formimit profesional, vizita të mbikëqyrura në kompani të ndryshme, intervista me mësues dhe me instruktorë të klubeve të ndryshme, panairi i sipërmarrjes së nxënësve, etj., të cilat i ndihmojnë nxënësit për njohjen e profesioneve, zhvillimin e aftësive që lidhen me ushtrimin e këtyre profesioneve.

Disa prej këtyre nuk janë përfshirë në planet vjetore dhe ato të orientimit për karrierën, pasi planet janë miratuar përpara daljes së urdhrit, por disa nga DRAP, ZVAP dhe IAP i kanë kryer këto veprimtari, jo vetëm në mungesë të fondeve buxhetore të dedikuara, por dhe të bazës logjistike dhe kapaciteteve institucionale të nevojshme për realizimin e tyre. Gjithçka realizohet në rrugë informale, me mbështetjen e aktorëve të ndryshëm, ose nuk realizohet fare dhe mbetet vetëm e shkruar në letër. Kjo gjë vështirëson punën jo vetëm të stafit mësues, por dhe të drejtuesve të DRAP/ZVAP dhe IAP.

Gjatë periudhës objekt auditimi nga ASCAP janë zhvilluar dy trajnime për koordinatorët e orientimit të karrierës për AMU, pasi trajnimet për AML nuk zhvillohen më vete, por së bashku me mësuesit për Maturën Shtetërore edhe përfaqësuesit e tjerë të DRAP-ve dhe ZVAP-eve, dhe jo me module konkrete për këtë veprimtari. Në mungesë të fondeve, kapacitetet njerëzore dhe logjistike janë të pamjaftueshme për realizimin e procesit të orientimit të karrierës me standardet e synuara.

7- Gjetje nga auditimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe institucionet e varësisë nuk kanë parashikuar fonde buxhetore, të nevojshme për realizimin e procesit të orientimit të karrierës, në të gjitha nivelet e sistemit arsimor parauniversitar.

Konkluzion: Mungesa e fondeve buxhetore të dedikuara, nuk ka garantuar një mekanizëm të qëndrueshëm në kuadrin e orientimit të karrierës, për nxënësit dhe gjithë aktorët e përfshirë në proces.

Observacion i Ministrisë të Arsimit dhe Sportit

Me shkresën e MAS me nr. 5517/2, datë 06.01.2025, protokolluar me tonën nr. prot.766/6, më datë 07.01.2025, janë përcjellë observacionet mbi Projekt Raportin dhe për problematikën e vënë në dukje konkretisht, parashtrojnë sa më poshtë:

“MAS ka përcaktuar dy rolet e reja të mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë dhe mësuesit koordinator për këshillimin e karrierës përmes Urdhrit nr. 463, datë 30.08.2024 ”Për përcaktimin e kriterëve për miratimin e ”mësuesit koordinator për sigurimin e cilësisë dhe të mësuesit koordinator të këshillimit të karrierës” në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar”” i cili përcakton edhe normën mësimore për mësuesit koordinatorë të këshillimit të karrierës (8-12 orë/javë) mbi bazën e së cilës llogariten edhe fondet buxhetore.”.

Qëndrimi i Grupit të Grupit të Auditimit:

Lidhur me sa observohet nga ana e MAS, parashtrimi nuk përcjell informacion shtesë, i cili do mund të cënonte përmbajtjen e gjetjes dhe rekomandimit.

Për sa më lart, **observacioni nuk merret në konsideratë.**

7.1 Rekomandimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit me rishikimin e kuadrit rregullator, të analizojë nevojat për fonde buxhetore të dedikuara në të gjitha nivelet e sistemit arsimor parauniversitar për orientimin e karrierës.

Brenda vitit 2025

➤ ***Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP) nuk është funksional.***

Orientimi për karrierë trajton probleme që lidhen jo vetëm me nxënësin por edhe me familjen, mjedisin social ku ai vepron, duke ndihmuar në lehtësimin e tensioneve në familje lidhur me vazhdimin e shkollimit të mëtejshëm. Në këtë proces rëndësi ka komunikimi, transparenca dhe bashkëpunimi me prindërit dhe komunitetin, për të krijuar shanse që nxënësit të bëjnë zgjedhje të suksesshme për të ardhmen e tyre profesionale.

Me VKM nr. 742, datë 03.12.2021 “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit të menaxhimit të informacionit parauniversitar”, Urdhrit nr. 589, datë 16.10.2023 “Për miratimin e rregullores për përdorimin e Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP)”, MAS ka miratuar sistemin SMIP, në të cilin përfshihet: Tabela e aftësive dhe prirjeve të nxënësit, Formulari i orientimit të nxënësit për Arsimin e Mesëm të Lartë dhe Letra orientuese për prindin. Në kuadër të orientimit për karrierën të nxënësve në arsimin e mesëm të ulët për klasat 6-9, janë marrë masat për vijimin e plotësimit në sistem të formularëve të orientimit të nxënësve të klasës së 9-të, për Arsimin e Mesëm të Lartë, prej datës 10 qershor 2024 e në vijim.

- Parashikimi i detyrimit të përdorimit të SMIP-it në sistemin arsimor parauniversitar, është i pambështetur në ligjin e arsimit parauniversitar, pasi aktet e sipërpërmendura nuk e kanë ligjin 69/2012 si referencë ligjore. SMIP ka zëvendësuar, të vetmin dokument ligjor në IAP, regjistrin dhe amzën në shkolla, dhe mbi bazën e rubrikave të paraqitura në të bëhet menaxhimi i informacionit të procesit mësimor në sistemin arsimor parauniversitar.
- Dhe me miratimin e Urdhrit nr. 300, datë 19.06. 2024 “Për disa ndryshime në Urdhrit nr. 31, datë 28.01.2020 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, Rregullorja e SMIP është në kundërshtim me Urdhrit nr. 31, datë 28.01.2020 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, pasi nuk mund të rishikohet një akt nënligjor si rregullorja e IAP, duke iu referuar një akti jo të bazuar në ligj, sikurse është rregullorja e SMIP.

Referuar Kreu II të Urdhrit nr. 589, datë 16.10.2023, institucionet përgjegjëse për SMIP, janë MAS, ASCAP, AKAP, DRAP, ZVAP dhe IAP, të cilat kanë disa detyra të përcaktuara, por që në momentin e implimentimit të tij, janë shfaqur problematikat e mëposhtme:

- Rubrika për orientimin e karrierës nuk është bërë aktive.
- Institucionet nuk janë angazhuar në raportimin dhe shmangien e problematikave të shfaqura nga sistemi SMIP.
- Administratori i SMIP për IAP, koordinatori për orientimin e karrierës nuk kanë akses te fleta orientuese për prindin, ndërkohë që administratori ka akses në regjistrin e notave.
- Mësuesi kujdestar ka akses te notat dhe fleta informuese.
- Nëpërmjet sistemit e-albania ku aplikohet fleta informuese e prindit, nuk konfirmohet marrja e informacionit nga prindi.
- Nuk ka asnjë njoftim zyrtar shkresor për fletën informuese, ku prindi të shprehë dakordësinë e tij për shkollimin e mëtejshëm të fëmijës.

Letra informuese plotësohet vetëm për nxënësit të cilët orientohen nga mësuesi kujdestar të ndjekin karrierën e tyre në sistemin e arsimit profesional.

Nga auditimi në terren, si dhe intervistat me mësues dhe drejtues të DRAP dhe ZVAP, u konstatua se problematikat e mësipërme kanë ndikuar pjesërisht dhe në shfaqjen e problemeve sociale në familje, pasi prindërit dhe nxënësit janë gjetur përballë zgjedhjesh të pamiratuara nga ana e tyre, lidhur me arsimin profesional. (.....nxënësit nuk kanë dëshirë të shkojnë në shkollat profesionale, pasi mjedisi në to është problematik;prindërit nuk kanë mundësi ekonomike për t'i mbështetur, si dhe nuk dëshirojnë t'i kenë fëmijët larg, në konvikte, pasi nuk

kanë sigurinë e duhur për mirëmenaxhimin e tyre;.....shkollimi në to nuk garanton mundësi punësimi në vendin e tyre).

Në intervistat e kryera në terren, grupit të auditimit i'u vu në dukje se në mungesë të informacionit ka patur refuzime nga prindërit, pse jo dhe nga nxënësit, pasi disa prej tyre nuk janë vënë në dijeni as nga mësuesit për orientimin e tyre drejt arsimit profesional.

Orientimi për Arsimin e Mesëm të Lartë, bazuar mbi vlerësimin e notave, krijon kushte për diskriminim të fëmijëve dhe paragjykim të perspektivave të karrierës së tyre, pasi kriter vlerësimi i vetëm është vetëm nota, dhe konkretisht ndarja dhe orientimi i nxënësve drejt arsimit profesional, bëhet për nxënësit që kanë një mesatare të ulët, pa u bazuar në talentin e vërtetë të tyre, qoftë i lindur apo i fituar.


Ky është një problem i cili na u bë prezent nga eprorët e IAP-eve, DRAP-eve dhe ZVAP-eve.

Tabela Nr. 5: Numri i nxënësve të orientuar drejt arsimit të mesëm të lartë profesional.

DRAP	Numri i nxënësve të klasave të 9-ta (Total)	Numri i nxënësve të klasave të 9-ta të cilëve ju është plotësuar letra informuese e prindit për orientimin drejt arsimit profesional
Fier	4969	843
Korçë	5668	1354
Durrës	13392	5059
Lezhë	3895	935
Total	27924	8191

Burimi: Të dhëna vënë dispozicion nga AKAP.

Figura Nr. 10: Numri i nxënësve të orientuar drejt arsimit të mesëm të lartë profesional



Burimi: Diagramë vënë dispozicion nga AKAP.

Koordinatorët, përfaqësuesit e DRAP dhe ZVAP mendojnë se ky sistem ka nevojë për përmirësim, në aspekte të ndryshme. Pavarësisht se, për të mbështetur institucionet arsimore, në bashkëpunim me ASCAP dhe AKAP, për plotësimin në sistemin SMIP të formularëve të orientimit të nxënësve të klasave të 9-ta, është hartuar “Materiali informues për plotësimin e formularëve të orientimit të nxënësit të klasës së 9-të për arsimin e mesëm të ulët” (Maj 2024), përsëri ka probleme në përditësimin e tij.

8- Gjetje nga auditimi: Sistemi i menaxhimit të informacionit parauniversitar (SMIP) nuk garanton bashkëpunimin e institucioneve me prindërit për ndërgjegjësimin e tyre lidhur me zgjedhjen e shkollimit të mëtejshëm të nxënësve, pasi nuk është bërë plotësisht funksional, por shfaq problematikat e mëposhtme:

- Është i pambështetur në ligjin e arsimit parauniversitar, pasi VKM nr. 742, datë 03.12.2021 dhe Urdhri nr. 589, datë 16.10.2023, nuk e kanë referencë të tyre ligjin nr. 69/2012 . Ky sistem ka zëvendësuar, të vetmet dokumentet ligjore në IAP, regjistrin dhe amzën në shkolla;
- Rregullorja e SMIP është në kundërshtim me Urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020 “*Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë*”;
- Rubrika për orientimin e karrierës nuk është bërë aktive;
- Administratori i SMIP për IAP, koordinatori për orientimin e karrierës nuk ka akses tek fleta orientuese për prindin;
- Nëpërmjet sistemit “e-Albania”, nuk konfirmohet marrja e informacionit nga prindi;
- Nuk ka asnjë njoftim zyrtar shkresor për fletën informuese, ku prindi të shprehë dakordësinë e tij për shkollimin e mëtejshëm të fëmijës.

Konkluzion: Në mungesë të funksionimit të rubrikës për orientimin e karrierës në sistemin SMIP, si dhe të marrjes së feedbackut nga prindërit në të gjitha format e mundshme, bashkëpunimi dhe vendimmarrja janë me risk dhe orientimi për karrierë është një proces joefektiv.

Observacion i Ministrisë të Arsimit dhe Sportit

Me shkresën e MAS me nr. 5517/2, datë 06.01.2025, protokolluar me tonën nr. prot.766/6, më datë 07.01.2025, janë përcjellë observacionet mbi Projekt Raportin dhe për problematikën e vënë në dukje konkretisht, parashtrohet sa më poshtë:

“Në faqen 37 të raportit të KLSH thuhet që numri i nxënësve të orientuar drejt arsimit të mesëm të lartë profesional është 8191. Dërgimi i fletëve informuese për këshillimin e karrierës është dhe ka qenë aktive që prej vitit të kaluar shkollor, kjo e konfirmuar me emaile dhe shkresa, por dhe verbalisht nga përdoruesit (mësuesit).”.

Qëndrimi i Grupit të Grupit të Auditimit:

Lidhur me sa observohet nga ana e MAS, parashtrimi nuk përcjell informacion shtesë, i cili do mund të cënonte përmbajtjen e gjetjes dhe rekomandimit.

Për sa më lart, **observacioni nuk merret në konsideratë.**

8.1 Rekomandimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit të marrë masat për rishikimin e Rregullores së përdorimit të SMIP dhe të bëjë plotësisht funksionale rubrikën për orientimin e karrierës në të, duke garantuar komunikimin dhe transparencën me prindërit.

Brenda gjashtëmuajorit të parë të 2025

4.3 A ka koordinim dhe raportim në mes të institucioneve përgjegjëse të sistemit të arsimit parauniversitar, në realizimin e procesit të orientimit për karrierë?


AKAP ka përgatitur dhe dërguar në DRAP-e dhe ZVAP-e tabelën e veprimtarive për aktivitetet e planifikuara të këshillimit të karrierës, vetëm për AML, në kuadër të Maturës Shtetërore, ndërkohë që për AMU nuk është bërë një planifikim i tillë. Në MAS dhe institucionet e varësisë, nuk ka raporte monitorimi dedikuar orientimit të karrierës. Ministria e Arsimit dhe e Sportit nuk ka bashkërenduar zbatimin e politikave me të gjithë partnerët e përfshirë në procesin e orientimit të karrierës, si pushtetin vendor, sektorin privat dhe

organizatat joqeveritare, nëpërmjet lidhjes së marrëveshjeve midis institucioneve të arsimit parauniversitar dhe tyre.

➤ **Koordinim dhe raportim**

Ministria e Arsimit dhe Sportit, AKAP dhe ASCAP si institucione përgjegjëse për përcaktimin e masave dhe të veprimtarive që ndërmarrin institucionet e sistemit arsimor parauniversitar, gjatë periudhës objekt auditimi dhe jo vetëm, duhet të përcaktojnë në aktet nënligjore të vitit shkollor përkatës, gjithçka për koordinimin dhe raportimin e veprimtarive lidhur me orientimin e karrierës.

Figura Nr. 6: Varësia institucionale e subjekteve nën auditim,



Burimi: Përpunuar nga Grupi i auditimit.

Në udhëzimet e përbashkëta të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për vitet shkollore 2021-2024⁴¹, për arsimin e mesëm të lartë nuk evidentohen përcaktime për veprimtaritë për këshillimin e karrierës, ndërsa për arsimin e mesëm të ulët, ka përcaktime në veprimtaritë e orientimit të karrierës referuar vitit 2023 e në vijim. Konkretisht, në nenin 6 “Arsimi bazë”, të Udhëzimit të Përbashkët midis MAS dhe MFE Nr. 15, datë 24.07.2023, për vitin shkollor 2023-2024 në sistemin arsimor parauniversitar, ka përcaktime për zbatimin e Urdhrit nr. 600, datë 19.10. 2023 “Për miratimin e udhëzuesit të orientimit për karrierën të nxënësve në arsimin e mesëm të ulët, (klasat 6-9)”. Pra, koordinimi institucional për orientimin e karrierës, pasqyrohet vetëm në AMU dhe jo në AML.

Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar në bashkëpunim me Drejtoritë Rajonale dhe Zyrat Vendore Arsimore, është përgjegjëse për bashkërendimin e zbatimit të politikave, nëpërmjet monitorimit, vlerësimit dhe mbi bazën e analizave të kryera, planifikon, organizimin dhe shtrirjen e shërbimit arsimor dhe orientimin për karrierë. AKAP monitoron në mënyrë të vazhdueshme punën e koordinatorit të DRAP dhe ZVAP, nëpërmjet planifikimit të veprimtarive që koordinatorët dorëzojnë në AKAP, si dhe raporteve të dërguara pranë saj.

Në zbatim të akteve nënligjore të sipërpërmendura, AKAP-i me shkresën nr. 313 prot., datë 23.01.2024 ka përgatitur dhe dërguar në DRAP-e dhe ZVAP-e “Tabelën e veprimtarive për aktivitetet e planifikuara në kuadër të këshillimit të karrierës”. Nga verifikimi u konstatua se kjo tabelë është e vlefshme vetëm për AML, pasi në të përfshihen veprimtari në kuadër të Maturës Shtetërore, ndërkohë që për AMU nuk është bërë një planifikim i tillë nga AKAP.

Nga konstatimet në terren rezultoi se, një pjesë e IAP-ve për vitin 2023-2024 kanë hartuar planet vjetore të shkollës dhe një pjesë e tyre, kanë dhe plane të orientimit të karrierës. Planet e orientimit të karrierës më së shumti janë të pamiratuara nga eprorët përkatës, ose janë formale,

⁴¹ Udhëzim i përbashkët nr. 13, datë 10.07.2024 “Për vitin shkollor 2024-2025 në sistemin arsimor parauniversitar”.

me një gamë të gjerë aktiviteteve dhe të parakorduara me planet vjetore të shkollës. Ndërkohë, nuk ka një informacion të detajuar pranë ZVAP-ve nga IAP-et, me relacionet përshkruese, si dhe feedback-un konkret mbi realizimin e veprimtarive të parashikuara në planet vjetore për orientimin e karrierës.

Në zbatim të Urdhrit nr. 43, datë 28.02.2023 “Për ngritjen e grupeve të punës për monitorimin e IAP-ve për marrjen e masave për Maturën Shtetërore dhe Provimet Kombëtare të Arsimit Bazë 2023 dhe orientimin për karrierën”, si dhe Urdhrit nr. 96, datë 03.05.2023 “Për ngritjen e grupeve të punës për monitorimin e IAP-ve për marrjen e masave për Provimet Kombëtare të Arsimit Bazë 2023 dhe orientimin për karrierën”, AKAP ka ngritur grupet e punës, të cilat kanë patur për detyrë të monitorojnë disa IAP-e, publike dhe jo publike dhe raporti i monitorimit të dorëzohet brenda një jave.

Sektori i Inspektimit dhe Vlerësimit të Cilësisë i AKAP-it, ka kryer monitorimet për AML dhe AMU, por gjithçka e përfshirë brenda Matricës së Maturës Shtetërore dhe PKAB 2023-2024, edhe pse disa ZVAP-e dhe IAP-e kanë patur planet e orientimit të karrierës. Grupit të auditimit i'u vunë në dispozicion disa nga raportet e sipërpërmendura, si dhe raporte mbi orientimin e karrierës për nxënësit e klasës së 9-të dhe 10, 11,12, për vitet shkollore 2021-2022, 2022 – 2023 dhe 2023-2024, të cilat janë rezultuar të ishin joperiodike, jospecifike për orientimin e karrierës dhe një pjesë e tyre të paprotokolluara.

Gjatë periudhës objekt auditimi, AKAP në muajin maj-qershor 2022 ka vlerësuar 8 shkolla 9-vjeçare “Për marrjen e masave për provimet kombëtare të arsimit bazë” dhe 8 shkolla të mesme “Për marrjen e masave për Maturën Shtetërore”, ku disa nga përshkruesit e vlerësimit janë për këshillimin e karrierës.

AKAP gjatë periudhës mars-maj 2023 ka vlerësuar 6 shkolla 9-vjeçare “Për marrjen e masave për PKAB dhe orientimi për karrierën” dhe 12 shkolla të mesme “Për marrjen e masave për Maturën Shtetërore”, ku përsëri disa nga përshkruesit janë për këshillimin e karrierës. Pavarësisht se këto raporte monitorimi janë dërguar në MAS, kjo e fundit nuk ka bërë ndonjë analizë për to, për të vlerësuar ecurinë e procesit të orientimit të karrierës.

Sektori i Inspektimit dhe Vlerësimit të Cilësisë, sikurse konstatohet mbulon një gamë të gjerë të veprimtarive të kryera nga DRAP-et, ZVAP-et dhe IAP-et (4 DRAP; 52 ZVAP; 1147 IAP publike; 235 IAP private; 256 kopshte) dhe kontrollon veprimtarinë e tyre përmes monitorimit/vlerësimit/inspektimit.

Numri i subjekteve dhe aktiviteteve të monitoruara është shumë i lartë në raport me kapacitetet njerezore të këtij sektori, i cili përbëhet nga një përgjegjës dhe gjashtë specialistë.

Tabela Nr. 6: Monitorime/vlerësime/inspektime të sektorit të IVC në AKAP

Periudha	2021	2022	2023	Janar-prill 2024	Total
Monitorime/vlerësime/inspektime	184	297	354	49	884

Burimi: AKAP, Përpunoi: Grupi i auditimit

Me shkresën nr. 1944 prot., datë 10.07. 2023 dhe shkresën nr. 267/9, datë 2024, AKAP ka dërguar në MAS dy raportet e përgatitura për orientimin e karrierës, për nxënësit e klasës së 9-të, respektivisht për vitin shkollor 2022-2023 dhe raportin tre mujor shtator-dhjetor 2023, për vitin shkollor në vijim.

Për këto raporte nga MAS nuk ka patur ndonjë analizë konkrete për të dhënat e pasqyruara, mbi bazën e të cilave të analizojë gjendjen dhe të përcaktojë strategjitë e veta për këtë proces. MAS ka vetëm një raport analize, të hartuar nga ASCAP në bashkëpunim me UNICEF, por kryesisht referuar edukimit kurrikular.

AKAP dhe ASCAP kanë regjistruar risku për vitin 2023, por nuk evidentohet në asnjë rast risku i parashikuar për orientimin e karrierës, apo ndikimi i këtij procesi në fenomenin e zvogëlimit të numrit të nxënësve dhe braktisjes së shkollës, etj.

9- Gjetje nga auditimi: Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (AKAP) ka përgatitur dhe dërguar në DRAP-e dhe ZVAP-e tabelën e veprimtarive për aktivitetet e planifikuara të këshillimit të karrierës, vetëm për AML, në kuadër të Maturës Shtetërore, ndërkohë që për AMU nuk është bërë një planifikim i tillë dhe për pasojë në MAS dhe institucionet e varësisë nuk ka raporte monitorimi dedikuar orientimit të karrierës.

Konkluzion: Mungesa e planifikimit të veprimtarive, koordinimit dhe raporteve të monitorimit cënon efektivitetin e procesit të orientimit të karrierës.

Observacion i Ministrisë të Arsimit dhe Sportit

Me shkresën e MAS me nr. 5517/2, datë 06.01.2025, protokolluar me tonën nr. prot.766/6, më datë 07.01.2025, janë përcjellë observacionet mbi Projekt Raportin dhe për problematikën e vënë në dukje konkretisht, parashtrohet sa më poshtë:

“Bazuar në Urdhrin nr. 463, datë 30.08.2024 ‘Për përcaktimin e kriterëve për miratimin e “mësuesit koordinator për sigurimin e cilësisë dhe të mësuesit koordinator të këshillimit të karrierës” në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar”, ASCAP në bashkëpunim me AKAP, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar miraton protokollin e punës për rolet e reja të mësuesve koordinatorë, mekanizmat monitorues dhe raportues në shkolla si dhe organizon punën për trajnimin e tyre.”.

Qëndrimi i Grupit të Grupit të Auditimit:

Lidhur me sa observohet nga ana e MAS, parashtrimi nuk përcjell informacion shtesë, i cili do mund të cënonte përmbajtjen e gjetjes dhe rekomandimit.

Për sa më lart, **observacioni nuk merret në konsideratë.**

9.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, mbi bazën e planifikimit të veprimtarive për orientimin e karrierës, të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme ecurinë e procesit dhe të vijojë raportimin e tyre në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

Menjëherë dhe në vijimësi

➤ Nuk është rritur bashkëpunimi dhe koordinimi me partnerët.

“Zhvillimi i veprimtarive dhe ofrimi i shërbimeve të orientimit për karrierën në shkolla kërkon zhvillimin e partneriteteve dhe bashkëpunimin me aktorë të tjerë. Ndërmjet tyre mund të përmendim: institucione arsimore të arsimit të mesëm të lartë, si shkolla të arsimit të mesëm profesional, shkolla të arsimit të mesëm të orientuar etj; përfaqësues të pushtetit lokal dhe të shërbimeve që ofrojnë; përfaqësues të botës së punës; sipërmarrje/biznese/kompani, etj”⁴².

Ministria e Arsimit dhe e Sportit, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar nëpërmjet bashkëpunimit me Drejtoritë Rajonale dhe Zyrat Vendore Arsimore, bashkërendojnë zbatimin e politikave me të gjithë partnerët e përfshirë në proces, për të krijuar lidhje ndërmjet shkollave dhe tregut të punës, ku nxënësit marrin informacion të drejtpërdrejtë për mundësitë e karrierës.

⁴² Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Sportit, Nr. 600, miratuar më 19.10.2023 “Udhëzuesi i Orientimit për Karrierën e Nxënësve në AMU (klasat 6-9)”.

Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, në një shkresë⁴³, dërguar DRAP-eve dhe ZVAP-eve, ka përcaktuar disa detyra për institucionet e arsimit të mesëm të lartë, mbi bazën e të cilave organizohen veprimtaritë për këshillimin e karrierës në bashkëpunim me IAL-të. Një nga detyrat e ZVAP-eve ka qenë ngritja e komisioneve të këshillimit të karrierës, pranë tyre dhe në institucionet e arsimit të mesëm të lartë për të koordinuar punën me IAP dhe IAL, lidhur me programet e studimit të këtyre të fundit, si dhe këndin e këshillimit të karrierës.

Në arsimin e mesëm të lartë kjo veprimtari diktohet nga IAL-et, të cilat kanë interes për të patur kuota të mjaftueshme për programe studimi, por jo prioritet përzgjedhjen e nxënësve sipas prirjeve dhe aftësive. Për realizimin e këtyre veprimtarive janë vënë në dispozicion mjediset e kërkuara për zhvillimin e takimeve me maturantët, IAL-të, mësuesit dhe prindërit, pa cënuar procesin mësuesor.

Çdo vit shkollor organizohet Panairi “Work & Study”, ku, përveç maturantëve, tashmë marrin pjesë dhe nxënësit e klasave IX, X dhe XI.

Nga auditimi në terren rezulton se, drejtoritë e IAP-eve, referuar shkresës nr. 7712 prot., datë 13.12.2023, “Për njohjen dhe informimin e nxënësve maturantë me institucionet e arsimit të lartë dhe programet e arsimit që ato ofrojnë”, kanë ngritur Komisionet e Këshillimit të Karrierës si dhe kanë zhvilluar aktivitetet e parashikuara për orientimin e nxënësve për karrierën, gjithçka në kuadër të Maturës Shtetërore.

Gjithashtu në pikën dh) të nenit 16 të Udhëzimit të Përbashkët Nr. 15, datë 24.07.2023, për vitin shkollor 2023-2024 në sistemin arsimor parauniversitar, midis MAS dhe MFE, përcaktohet zbatimi i marrëveshjes së bashkëpunimit për Këshillimin e Karrierës për nxënësit e arsimit parauniversitar nr. 2996/2, të datës 05.05.2022, midis Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Bashkisë Tiranë. Sipas informacionit vënë në dispozicion nga MAS⁴⁴, zbatimi i kësaj marrëveshje ka patur objekt të saj shpërndarjen e moduleve të trajnimit sipas programit pilot në 6 shkollat: Petro Nini Luarasi, Qemal Stafa, Sandër Prosi, Kosova, Dora D’Istria, dhe Ardian Klosi. Referuar vitit shkollor 2023 - 2024 kanë marrë shërbim rreth 3.700 nxënës nga klasa e tretë, deri në klasën e 12-të, por gjithmonë mbetemi në kuadër të edukimit kurrikular. Nga auditimi në terren, konstatohet se në institucionet arsimore të AML-ve, koordinimi institucional pjesërisht është realizuar, por në mënyrë vullnetare, sporadike, me iniciativa të drejtuesve të DRAP-ve dhe ZVAP-ve, por jo si një detyrim ligjor i mirëfilltë.

10- Gjetje nga auditimi: Ministria e Arsimit dhe e Sportit nuk ka bashkërenduar zbatimin e politikave me të gjithë partnerët e përfshirë në procesin e orientimit të karrierës, si pushtetin vendor, sektorin privat dhe organizatat joqeveritare për të krijuar lidhje ndërmjet shkollave dhe tregut të punës, të konkretizuara me marrëveshje bashkëpunimi. MAS ka vetëm dy marrëveshje bashkëpunimi, një me Bashkinë e Tiranës dhe një me Ministrinë e Mbrojtjes.

Konkluzion: Mungesa e bashkërendimit dhe koordinimit të politikave me të gjithë partnerët e përfshirë në proces si, pushtetin vendor, sektorin privat dhe organizatat joqeveritare, ka vështirësuar krijimin e lidhjeve ndërmjet shkollave dhe tregut të punës.

Observacion i Ministrisë të Arsimit dhe Sportit

Me shkresën e MAS me nr. 5517/2, datë 06.01.2025, protokolluar me tonën nr. prot.766/6, më datë 07.01.2025, janë përcjellë observacionet mbi Projekt Raportin dhe për problematikën e vënë në dukje konkretisht, parashtrohet sa më poshtë:

“Në kuadër të këshillimit për karrierën, MAS bashkëpunon edhe me Pushtetin Vendor. Kështu në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit që MAS ka me Dhomën e Tregtisë

⁴³ Shkresa nr. 3649/1 prot., datë 29.12.2023, me lëndë: “Për njohjen dhe informimin e nxënësve maturantë me institucionet e arsimit të lartë dhe programet e studimit që ato ofrojnë”.

⁴⁴ E-mail i datës. 26.09.2024

dhe Industrisë në Tiranë, nënshkruar në vitin 2018, organizohet panairi Work&Study në muajin prill të çdo viti. MAS gjithashtu mundëson pjesëmarrjen e Institucioneve të Arsimit të Lartë, në veprimtari të planifikuara për njohjen e nxënësve maturan të me programet e studimit. Dhoma e Tregtisë vë në dispozicion të MAS informacionin mbi kërkesat që ka tregu i punës, bizneset, si dhe shkallën e kualifikimit të tyre.”.

Qëndrimi i Grupit të Grupit të Auditimit:

Lidhur me sa observohet nga ana e MAS, parashtrimi nuk përcjell informacion shtesë, i cili do mund të cënonte përmbajtjen e gjetjes dhe rekomandimit. Ndërkohë që Memorandumi i sipërmendur, në observacion nga ana e MAS, nuk i është vënë në dispozicion Grupit të Auditit, në asnjë fazë të auditimit, madje as bashkëngjitur observacionit, si dokument provues i sa pohuar. Për sa më lart, **observacioni nuk merret në konsideratë.**

10.1 Rekomandimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit të koordinojë zbatimin e politikave për orientimin e karrierës, si dhe të nxisë krijimin e marrëveshjeve të reja të bashkëpunimit mes institucioneve të arsimit parauniversitar, pushtetit vendor, sektorit privat dhe organizatave joqeveritare.

Menjëherë dhe në vijimësi

KONTORLLI I LARTË I SHTETIT